

Të nderuar,

Situata lidhur me konfliktin ushtarak rus-ukrainas që u krijua nga fundi i shkurtit 2022 shkaktuan çrregullime serioze në tregjet globale të ushqimit dhe energjisë. Pas një periudhe më të gjatë të stabilitetit global dhe rajonal të çmimeve, po ballafaqohemi me trysni të fuqishme të inflacionit. Duke pasur parasysh se ekonomia vendase nevojat për ushqim dhe energji i plotëson nga importi, siç edhe nuk mund të ndikojë mbi lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare, trendet e rritjes së përgjithshme të çmimeve janë të pranishme edhe tek ne. Politikat qeveritare dhe politikat e Bankës Popullore janë para së gjithash në drejtim të lehtësimit të pasojave të papërshtatshme të rritjes së çmimeve për standardin jetësor të qytetarëve dhe ekonomisë. Masat e Qeverisë lidhen kryesisht me mbrojtjen e kategorive sociale vulnerabile të qytetarëve nëpërmjet subvencionimit të faturave të rrymës elektrike, si dhe ngrirjes së çmimeve të artikujve të caktuar ushqimorë, kurse Banka Popullore i shfrytëzoi kompetencat të cilat i ka në pjesën e zbatimit të politikës monetare, dhe nëpërmjet disa vendimeve të njëpasnjëshme kreu zmadhim të normës themelore të kamatës, që në fund të vitit 2022 ajo të jetë 4,75%.

Rritja e çmimeve u ndje edhe në punën e shoqërive të sigurimit dhe brokerëve dhe përfaqësuesve të sigurimit. Është evident zmadhimi i shpenzimeve gjatë trajtimit dhe pagesës së dëmeve të automjeteve motorike të siguruara dhe për shërbimet e riparimit. Përveç këtyre, janë zmadhuar edhe shpenzimet administrative të shoqërive.

Edhe përkrah zmadhimit të shpenzimeve, shoqëritë e sigurimeve e përmbyllën vitin 2022 me rezultate të përmirësuara financiare në krahasim me vitin e kaluar.

Kjo, para së gjithash, ka të bëjë me përzgjedhjen e përmirësuar të rreziqeve dhe zmadhimit të çmimeve të sigurimit, primeve të sigurimit, të cilat janë kategoria më e rëndësishme e të hyrave.

Në portofolion e sigurimeve jo-jetë ka një rritje vjetore të primeve në të gjitha klasat e

sigurimit përveç sigurimit të pronës, ku vihet re një zvogëlim i vogël i primit të shkruar bruto. Primi vjetor për sigurim të jetës është zmadhuar. Kryesisht për shkak të zmadhimit të shitjes së polisave të sigurimit të jetës të cilat mbulojnë vetëm rrezikun e vdekjes, si dhe të zmadhimit të të a.q. unite-linked sigurime të jetës ku të siguruarit e ndërmarrin rrezikun e investimit të fondeve të tyre të cilat vijnë në investohen në përfitimin e aksioneve apo pjesëmarrjes të lëshuar nga fondet investuese në vend.

Përveç zmadhimit të primeve vërehet edhe zmadhimi i dëmeve të paguara. Zmadhim është vërejtur edhe në provigjonet teknike të shoqërive të sigurimeve. Provigjont teknike janë indikator i rëndësishëm për aftësinë paguese të shoqërive të sigurimeve. Ato i përfaqësojnë obligimet e shoqërive për marrëveshjet e sigurimit. Burimi për mbulimin e këtyre obligimeve janë mjetet që shoqëritë e sigurimeve paguajnë në bazë të premisave të polisave. Shoqëritë e sigurimeve menaxhojnë me mjetet në mënyrë të kujdesshme, në përputhje me kërkesat që janë në rregullativën ligjore. Gjithashtu, gjatë përzgjedhjes së llojit të investimit të këtyre mjeteve, shoqëritë e sigurimeve duhet të kenë kujdes për natyrën, afatin dhe valutën e obligimeve, përkatësisht të vetë marrëveshjeve të sigurimeve.

Vitin e kaluar, përveç rreziqeve inhereente të pranishme për veprimtarinë e sigurimit, u shfaqën edhe rreziqe të jashtme që lidhen me zmadhimin e inflacionit. Efekti i zmadhimit të normës themelore të kamatës pres të ndjehet në tregjet e sigurimit këtë vit dhe në vitet e ardhme, dhe kryesisht në segmentin e sigurimit të jetës. Zmadhimi i inflacionit nuk i përkeqëson performancat financiare të shoqërive të sigurimit. Përkundrazi, rezultatet financiare të kaluar dëshmojnë se tregu i sigurimit ka pasur realizime më të mira në krahasim me vitin 2021. Për ne si rregullator, është e rëndësishme përveç ruajtjes së aftësisë paguese dhe stabilitetit të sektorit të sigurimit, të shohim edhe një përmirësim të theksuar në cilësinë e shërbimeve. Konsideroj se për këtë nevojitet të zmadhohet

transparenca gjatë krijimit të prodhimeve të sigurimit, çmimin me të cilin ofrohen, rreziqet që janë objekt sigurimi dhe përjashtimet në cilat raste të siguruarit nuk do të mbulohen nga sigurimi. Me fjalë të tjera, në këtë segment, nevojiten ndryshime të strukturuar të cilat do të mundësojnë përfshirje dhe akses më të madhe të shërbimit cilësor të sigurimit. Konsideroj se ekziston një popullatë e madhe e personave të pasiguar të cilët duhet të përfshihen në sistemin e sigurimit. Kjo duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të kenë mundësi të përzgjedhin nga oferta e mbulesave konkurrense dhe cilësore të sigurimit. Nga ana tjetër do të kenë informacione të mjaftueshme se çfarë marrin për çmimin që paguajnë.

Vitin e kaluar u ballafaquam me lëvizje në personelin ekspert në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Një pjesë e kolegëve tanë i ndërprejnë marrëdhëniet e punës, kurse në të njëjtën periudhë punësuam kuadër të ri. Në përputhje me mandatin dhe misionin tonë investojmë në përsosjen e tyre profesionale me qëllim që t'i kryejnë me ligj, me profesionalizëm, me paanshmëri dhe në kohë detyrat e përditshme të punës.

Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë numëron pesë anëtarë dhe është organ i cili merr vendimet, përkatësisht organ i menaxhimit dhe udhëheqjes me Agjencinë. Gjatë vitit 2022 kemi mbajtur 31 seanca gjithsej.

Gjatë vitit i zbatuam edhe të gjitha aktivitetet e planifikuara lidhur me trajnimet dhe provimet për akutar të autorizuar, si dhe për broker sigurimesh dhe përfaqësues në sigurime.

Aktivitetet lidhur me licencimin dhe mbikëqyrjen realizohen në kohë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit. Në pjesën e mbikëqyrjes off-site dhe mbajtjes së regjistrave kemi përmirësim të jashtëzakonshëm të proceseve falë funksionimit të softuerit të ri të mbikëqyrjes.

Pjesëmarrja jonë në punën e kolegjeve të mbikëqyrjes ishte në përputhje me dinamikën e paraparë si dhe me planin e aktiviteteve. Takimet e punës i mbajtëm në distancë dhe

në këtë mënyrë dakorduam të gjitha angazhimet e punës në lidhje me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve me organet e mbikëqyrjes nga vendet anëtare të BE-së.

Edhe përkrah faktit që nuk jemi vend anëtar i BE-së, dhe që ligji themelor i cili e rregullon veprimtarinë e sigurimit të ne nuk është rakorduar me kërkesat e direktivave dhe rregullativave evropiane, këmbëngulim të ndërtojmë praktikë të mbikëqyrjes kompakte dhe të krahasueshme me të njëjtën praktikë, të cilën e zbatojnë kolegët tanë të vendeve anëtare të BE-së. Konsiderojmë se në këtë mënyrë japim një pasqyrë të qartë dhe të paanshme mbi pritjet tona nga subjektet që ofrojnë shërbime të sigurimeve, por edhe kontribuojmë në përmirësimin e mëtejshëm në pikëpamje të rreziqeve dhe menaxhimit me to nga kompanitë e sigurimit dhe kanalet e tyre të shitjes.

Përdorimi i teknologjisë në sigurim padyshim se po zmadhohet, edhe pse ka pak, dhe në një vend, të dhëna të sublimuara për këto trende. Agjencia bashkëpunon me organet e tjera rregullatore financiare për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit FinTek. Zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi i saj në ushtrimin e veprimtarisë dhe në mbikëqyrje duhet të mundësojë përfshirje dhe akses më të madh në shërbimet e sigurimit, si dhe kuptimin dhe menaxhimin më të mirë të rreziqeve në vetë shoqëritë e sigurimeve. Hyrja e teknologjisë duhet të mbështetet me përforsim të edukimit dhe arsimimit financiar.

Punojmë intensivisht në përforsimin e perceptimit publik të institutit Ankesë - e drejtë të cilën e ka çdo i siguar kur vlerëson se cilësia e shërbimit të cilën ia jep shoqëria për sigurim nuk është në nivelin e duhur. Dhe tashmë kemi rezultate të shprehura nëpërmjet faktit sepse po rritet vazhdimisht numri i ankesave që vijnë në Agjenci nga të siguruarit. Kjo përfundimisht dhe në një periudhë afatgjatë e përmirëson vetëdijen publike për rëndësinë e sigurimit dhe është barometër tregu për cilësinë e shërbimit që ua japin shoqëritë të siguarve të tyre.

Në fund, por sigurisht jo e fundit, ju ftoj me kënaqësi të njiheni me realizimet e subjekteve

të tregut në vitin 2022, sfidat para të cilave
jemi vendosur, si dhe me aktivitetet dhe
planet tona.

Me respekt,
Kërste Shajnoski. n.p.



AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

RAPORTI VJETOR
MBI GJENDJEN DHE LËVIZJEN NË TREGUN E SIGURIMEVE NË VITIN 2022

Shkup, 2023

Raporti është përgatitur në përputhje me nenin 158-n të Ligjit për Mbikëqyrje të Sigurimeve. Për hartimin e tij Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ka përdorur të dhëna nga raportet të cilat subjektet ia dorëzojnë Agjencisë në përputhje me kërkesat ligjore. Për saktësinë e të dhënave përgjigjen subjektet e mbikëqyrjes.

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	6
2. KORNIZA LIGJORE	7
3. MJEDISI VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR	9
4. TREGU I SIGURIMEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	12
4.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE	12
4.1.1. STRUKTURA E PRONËSISË	12
4.1.2. NORMA E ZHVILLIMIT	12
4.1.3. PRIMI I SHKRUAR BRUTO	15
4.1.4. STRUKTURA E PJESËMARRJES	19
4.1.5. DËME TË PAGUARA BRUTO	22
4.1.5.1. ANKESA NGA TË SIGURUARIT	24
4.1.6. FONDET DHE BURIMET E FONDEVE	27
4.1.6.1. STRUKTURA E FONDEVE	27
4.1.6.2. STRUKTURA E BURIMEVE TË FONDEVE	29
4.1.7. PROVIGJONET TEKNIKE	31
4.1.8. FONDE TË CILAT I MBULOJNË PROVIGJONET TEKNIKE	31
4.1.9. ADEKUATSHMËRIA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE	33
4.1.10. REZULTATI FINANCIAR I PUNËS	34
4.1.10.1. RREZIQE NË SEKTORIN E SIGURIMEVE	35
4.1.11. INDIKATORË PËR SEKTORIN E SIGURIMIT	36
4.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME	39
4.2.1. PËRFAQËSIMI NË SIGURIME	39
4.2.2. VEPRIMTARI BROKERIMI NË SIGURIME	40
4.3. BYROJA NACIONALE E SIGURIMEVE	42
4.3.1. FONDI GARANTUES I BNS-SË	42
4.3.2. RIMBURSIMI I DËMEVE NGA FONDI GARANTUES	43

LISTA E TABELAVE

TABELA NR. 1: INDIKATORËT MË TË RËNDËSISHËM PËR VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE NË VITIN 2022	10
TABELA NR. 2: STRUKTURA E PRONËSISË E SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE (PËRQINDJE)	12
TABELA NR. 3: INDEKSI HERFINDAL DHE INDIKATORI CR5 I MATUR SIPAS PBSH-SË	14
TABELA NR. 4: INDEKSI HERFINDAL DHE INDIKATORI CR5 I MATUR SIPAS FONDEVE	14
TABELA NR. 5: PRIMI I SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT (MIJË DENARË)	15
TABELA NR. 6: PRIMI I SHKRUAR BRUTO PËR SHOQËRITË E SIGURIMEVE JO-JETË (MIJËRA DENARË)	16
TABELA NR. 7: PRIMI I SHKRUAR BRUTO PËR SHOQËRITË E SIGURIMEVE JETË (MIJËRA DENARË)	17
TABELA NR. 8: PRIMI I SHKRUAR BRUTO PËR PERIUdhËN 01.01.2022 – 31.12.2022 (MIJËRA DENARË)	18
TABELA NR. 9: PRIMI I SHKRUAR BRUTO PËR SIGURIM JETË, NË MIJËRA DENARË	21
TABELA NR. 10: DËMET E PAGUARA SIPAS KLASAVE TË SIGURIMEVE (MIJËRA DENARË)	23
TABELA NR. 11: NUMRI I DËMEVE TË PAGUARA	24
TABELA NR. 12: ANKESA TË DORËZUARA NË SHOQËRITË E SIGURIMEVE PËR VITIN 2022	25
TABELA NR. 13: ANKESAT E DORËZUARA NGA TË SIGURUARIT NË AMS NË VITIN 2022	26
TABELA NR. 14: STRUKTURA E FONDEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE JO-JETË (MIJËRA DENARË)	27
TABELA NR. 15: STRUKTURA E FONDEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE JETË (MIJËRA DENARË)	28
TABELA NR. 16: STRUKTURA E BURIMEVE TË FONDEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE JO-JETË (NË MIJËRA DENARË)	29
TABELA NR. 17: STRUKTURA E BURIMEVE TË FONDEVE TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE JETË (NË MIJË DENARË)	29
TABELA NR. 18: KOEFICIENTE TEKNIKE	37
TABELA NR. 19: INDIKATORË FINANCIARË	38
TABELA NR. 20: STRUKTURA E KANALEVE TË SHITJES SË POLISAVE SIPAS PSHB-SË (MIJË DENARË)	39
TABELA NR. 21: PJESËMARRJA E FONDIT GARANTUES SIPAS SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE PËR PERIUdhËN 01.01.2022 – 31.12.2022 (NË DENARË)	43
TABELA NR. 22: DËMET E PARAQITURA DHE TË PRANUARA PËR RIMBURSIM NGA FONDI GARANTUES PËR PERIUdhËN 01.01.2022 – 31.12.2022	44

LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU NR. 1: TREGUES TË ZHVILLIMI TË TREGUT TË SIGURIMEVE (MILIONA DENARË; BOSHTI I DJATHË - PËRQINDJE)	13
GRAFIKU NR. 2: PËRQENDRIMI I TREGUT SIPAS PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO NË VITIN 2022, NË GRUPIN E SIGURIMIT JO-JETË (PËRQINDJE)	14
GRAFIKU NR. 3: PËRQENDRIMI I TREGUT SIPAS PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO NË VITIN 2022, NË GRUPIN E SIGURIMIT TË JETË (PËRQINDJE)	15
GRAFIKU NR. 4: STRUKTURA E PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT (PËRQINDJE)	19
GRAFIKU NR. 5: TRENDI I PRIMIT TË SHKRUAR BRUTO SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT (MILIONË DENARË; BOSHTI DJATHHTAS – PËRQINDJA)	20
GRAFIKU NR. 6: MARRËVESHJE TË LIDHURA TE SHOQËRITË E SIGURIMEVE (BOSHTI MAJTAS - NUMRI; BOSHTI DJATHHTAS – NDRYSHIMI VJETOR NË PËRQINDJE)	22
GRAFIKU NR. 7: PJESËMARRJA E SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE NË DËMET E PAGUARA SHITESË NË VITIN 2022 (MIJË DENARË), VEÇMAS PËR JO-JETË DHE JETË.	23
GRAFIKU NR. 8: STRUKTURA E AKTIVES SË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE MË 31.12.2022, VEÇMAS PËR JO-JETË DHE JETË	28
GRAFIKU NR. 9: STRUKTURA E BURIMEVE TË FONDEVE, SHOQËRI TË SIGURIMEVE – JO-JETË, NË MILIONË DENARË MË 31.12.2022	30

GRAFIKU NR. 10: STRUKTURA E BURIMEVE TË FONDEVE, SHOQËRI E SIGURIMEVE – JETË, NË MILIONË DENARË MË 31.12.2022	31
GRAFIKU NR. 11: MBULIMI I PROVIGJONEVE NETO-TEKNIKE TE SHOQËRITË E SIGURIMEVE JO-JETË (MILIONA DENARË; BOSHTI DJATHTAS – PËRQINDJE).....	32
GRAFIKU NR. 12: MBULIMI I PROVIGJONEVE NETO-TEKNIKE TE SHOQËRITË E SIGURIMEVE JETË (MILIONA DENARË; BOSHTI DJATHTAS – PËRQINDJE).....	32
GRAFIKU NR. 13: LËVIZJA E KAPITALIT DHE MARGJINA E NEVOJSHME E AFTËSISË PAGUESE TE SHOQËRITË E SIGURIMEVE (MILIONË DENARË)	33
GRAFIKU NR. 14: STRUKTURA E KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE (VEÇMAS PËR JO-JETË DHE JETË), NË MILIONË DENARË DHE NË PËRQINDJE NGA KAPITALI I PËRGJITHSHËM.....	34
GRAFIKU NR. 15: REZULTATI FINANCIAR NGA PUNA E SHOQËRIVE TË SIGURIMEVE (MILIONË DENARË)	35
GRAFIKU NR. 16: STRUKTURA E PSHB-SË, SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT	40
GRAFIKU NR. 17: STRUKTURA E PSHB-SË SIPAS KLASAVE TË SIGURIMIT	41

1. HYRJE

Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin që vijon “AMS”) është trup rregullator i pavarur në tregun e sigurimeve i cili ushtron autorizime publike të përcaktuara me Ligjin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve dhe Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport. AMS-ja ka për qëllim të kontribuojë në funksionimin e ligjshëm dhe efikas të tregut të sigurimeve në vend, në zhvillimin e vazhdueshëm të tij, në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të siguruarve, si edhe në përparimin e stabilitetit financiar në vend.

Gjatë vitit 2022, pavarësisht zhvillimit të pavolitshtëm të rreziqeve nga mjedisi i jashtëm të shkaktuar nga pandemia e virusit korona, rritja e inflacionit dhe ngadalësimi i zhvillimit ekonomik, sektori vendas i sigurimit dëshmoi pozitë likuiditeti dhe aftësie paguese të shëndetshme dhe realizoi rezultat financiar pozitiv. Me këtë, tregoi gatishmëri të mirë për ballafaqim me goditjet, për të cilën kontribuoi gjendja e mirë e sektorit para pandemisë, por edhe masat e marra nga AMS-ja si përgjigje ndaj krizës.

Në fund të vitit 2022 në tregun e sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut punojnë aktivisht 16 shoqëri të sigurimeve, prej të cilave 11 shoqëri punojnë në sigurim jo-jetë, kurse 5 sigurim jete. Në sektorin e ndërmjetësimit, në fund të vitit 2022 aktive janë 42 shoqëri brokerimi në sigurime, 12 shoqëri për përfaqësim në sigurime dhe 8 banka të cilat ushtrjnë aktivitetin e përfaqësimit në sigurime.

Primi i Përgjithshëm i Shkruar Bruto (në tekstin që vijon: “PSHB”) në vitin 2022 është 12.785.429 mijë denarë, që përbën zmadhim prej 9,94% në raport me PSHB-në të realizuar në vitin 2021 (2021: 11.629.700 mijë denarë). Në pjesën e sigurimit jo-jetë është realizuar PSHB-ja në shumë prej 10.508.927 mijë denarësh (2021: 9.627.926 mijë denarë), përkatësisht rritje prej 9,15% në krahasim me vitin 2021. Njëkohësisht, te sigurimi jetë është realizuar PSHB në shumë prej 2.276.502 mijë denarësh (2021: 2.001.774 mijë denarë) që është rritje prej 13,72%.

Shoqëritë e sigurimit më 31.12.2022 disponojnë me fonde me vlerë prej 30.393.398 mijë denarësh, të cilat janë zmadhuar me 6,6% në raport me vitin e kaluar (2021: 28.512.618 mijë denarë). Kapitali i përgjithshëm i llogaritur¹ i shoqërive të sigurimeve shënon zmadhim prej 1,58% në krahasim me vitin 2021 dhe, në fund të vitit 2022 është 7.241.199 mijë denarë. Niveli i nevojshëm i margjinës së aftësisë paguese, si indikator kryesor i vlerësimit të stabilitetit të sektorit të sigurimit, i agreguar është 2.045.720 mijë denarë, kështu që kapitali i sektorit të sigurimit është 3.54 herë mbi nivelin e nevojshëm të margjinës së aftësisë paguese.

Gjatë vitit 2022, sektori i sigurimit dëshmoi fitim para tatimit në shumë prej 631.835 mijë denarësh. Shoqëritë e sigurimeve jo-jetë kanë realizuar fitim prej 380.283 mijë denarësh, kurse, fitimi i shoqërive për sigurim jetë para tatimit është 251.553 mijë denarë.

Në fushën e normativës ligjore në vitin 2022 janë miratuar 6 ndryshime të akteve nënligjore që vlejné tashmë dhe 1 akti të ri nënligjor. Gjithashtu, në mars të vitit 2022, Këshilli i Ekspertëve të AMS-së merr qëndrim t’u rekomandojë kompanive të sigurimit që të mos shpërndajnë dhe paguajnë dividendë nga fitimi i realizuar në vitin 2021, atë ta shpërndajnë për rritjen e rezervave të sigurisë dhe pjesën tjetër të rezervave të shoqërisë, derisa ka pasiguri për kohëzgjatjen e krizës dhe vlerësimin e rrezikut për gjendjen dhe stabilitetin e tyre financiar.

¹ Në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve, kapitali i shoqërisë së sigurimeve në një datë të caktuar të llogaritjes mund të ketë dallim nga shuma e kapitalit dhe rezervave, të pasqyruara në bilancin e gjendjes në të njëjtën datë.

2. KORNIZA LIGJORE

Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/02, 98/02, 79/07, 88/08, 67/10, 44/11, 112/11, 188/13, 30/14, 43/14, 112/14, 153/15, 92/15, 23/16, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/19, 31/20 dhe 173/22), Ligji për Sigurim të Detyrueshëm në Transport (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 88/05, 70/06, 81/08, 47/11, 135/11, 112/14 dhe 145/15 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 220/19), Ligji për Sigurime Vullnetare Shëndetësore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/12 dhe 192/15), Ligji për Pagim të Pensioneve dhe Përfitimeve Pensionale nga Sigurimet Pensionale me Financim Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 11/12, 147/15 dhe 30/16) dhe Ligji për Parandalim të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 151/22), Ligji për Investim në Republikën e Maqedonisë në Kapital Aksionar të Evropa RE (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 185/11), Ligji për Stabilitet financiar (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut ” nr. 173/ 22) Ligji për Masat Restriktive (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 190/12) janë korniza ligjore themelore e cila i normativizon kushtet dhe mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të ndërmjetësimit në sigurime dhe zbatimin e mbikëqyrjes së aktivitetit të shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit të sigurimeve dhe shoqërive të përfaqësimit në sigurime.

Kornizën më të gjerë ligjore e përfaqësojnë Ligji për Marrëdhënie Obligative në pjesën që lidhet me marrëveshjet e sigurimeve dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Ligji për Mbikëqyrje të Sigurimeve i inkorporon parimet dhe standardet e sigurimeve të Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), si dhe direktivat për sigurime të Bashkimit Evropian (BE). Me këtë ligj normativizohet themelimi dhe puna e shoqërive të sigurimeve, menaxhimi me rreziqet, roli i aktuarëve të autorizuar, mbajtja e regjistrave të biznesit dhe raporteve, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, përfaqësimi dhe ndërmjetësimi në sigurimet, mbikëqyrja e shoqërive të sigurimeve, puna e AMS-së, zbatimi i mbikëqyrjes dhe procedura për marrjen e aktvendimeve nga AMS-ja, bashkëpunimi me organet dhe trupat mbikëqyrëse të BE-së, si dhe dispozitat ndëshkuese.

Sigurimi i detyrueshëm në transport rregullohet me **Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm në Transport**, i cili i rregullon kontratat e sigurimit të detyrueshëm, shumat minimale të sigurimit, afatet e raportimit dhe kompensimit të dëmeve nga shoqëritë e sigurimeve, përcaktimin e së drejtës për ndërmjetësim (mediacion), kompetencat e Fondit të Garancisë, ndryshimin e mënyrës së përcaktimit të tarifave të primit përmes funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Autopërgjegjësish dhe dispozitat ndëshkuese për shoqëritë e sigurimeve dhe Byronë Nacionale të Sigurimeve. Ligji përcakton, gjithashtu, detyrimet që shoqëritë e sigurimeve të caktojnë përfaqësues të autorizuar për dëmet jashtë vendit në mënyrë që viktimat e aksidenteve rrugore të kenë akses të lehtë dhe të shpejtë në paraqitjen e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga automjetet e vendit jashtë tij, si dhe të krijojnë Shërbim për Kompensim të Dëmeve, si garanci për viktimat e aksidenteve rrugore jashtë vendit, madje edhe nëse shoferi përgjegjës ka drejtuar automjet të pasiguar, dëmi do të trajtohet dhe paguhet në kohën e duhur. Disa nga këto dispozita tashmë kanë hyrë në fuqi, ndërsa disa të tjera do të hyjnë në fuqi nga momenti i anëtarësimit të plotë të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Me **Ligjin për sigurim vullnetar shëndetësor** jepet mundësi ligjore dhe hapet një fushë e gjerë veprimi për shoqëritë e sigurimeve për oferta të pakove të shërbimeve shëndetësore të cilat janë përfshirë tashmë me sistemin e sigurimit të obligueshëm shëndetësor. Sigurimi vullnetar shëndetësor normativizohet si sigurim suplementar dhe privat. Sigurimi suplementar shëndetësor siguron mbulim të shpenzimeve në emër të pjesëmarrjes me mjete personale për shfrytëzim të shërbimeve shëndetësore nga sigurimi i detyruar shëndetësor (participim), në përputhje me dispozitat e sigurimit të detyruar shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore. Sigurimi privat

shëndetësor mundëson mbulim të shpenzimeve për përdorim të shërbimeve shëndetësore për standard më të lartë të shërbimeve shëndetësore të cilat dalin nga sigurimi i detyruar shëndetësor, shpenzimet për mbulim të shërbimeve shëndetësore të përdorura në veprimtari shtesë, si dhe për përdorim të shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore ku kryhet veprimtaria shëndetësore dhe te personat juridikë të cilët realizojnë prodhimin, dhënie dhe servisim të mjeteve ortopedike dhe mjeteve të tjera ndihmëse.

Me **Ligjin për pagim të pensioneve dhe kompensimeve pensionale nga fusha e sigurimit pensional me financim kapital** përfundoi normativizimi i sigurimit kapital financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me rregullim të fazës së deakumulimit, përkatësisht me këtë Ligj rregullohen pagesat e pensioneve nga shtylla e dytë dhe kompensimet e pensionit nga shtylla e tretë. Në ligj në mënyrë të hollësishtme rregullohen llojet e pagesave të pensioneve në shtyllën e dytë (tërheqje të programuara, anuitete të përjetshme dhe kombinimi i tyre), llojet e pagesave të kompensimeve të pensionit nga shtylla e tretë (tërheqje të programuara, anuitete, pagesa të njëfishta dhe të shumëfishta), karakteristika dhe rregulla për lloje të ndryshme të pagesave dhe mënyra dhe procedura e fitimit të së drejtës së pensionit në bazë të moshës, pension invalidi dhe pension familjar nga shtylla e dytë, si dhe procedurë për fitimin e së drejtës të kompensimit pensional nga shtylla e tretë. Në këtë Ligj rregullohet edhe se cilat institucione do të mund të bëjnë pagim të pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve nga shtylla e dytë dhe e tretë - shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimeve të jetës. Gjithashtu, për shkak të transparencës më të madhe të përzgjedhjes së pensionit nga shtylla e dytë dhe kompensimit të pensionit nga shtylla e tretë, u vendos Sistem elektronik i centralizuar i kotacionit nëpërmjet të cilit do të dorëzohen kërkesa për kotacione për lloje të ndryshme të pagesave dhe do të merren oferta nga shoqëritë pensionale dhe shoqëritë e sigurimeve.

Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit përcakton kompetencën e AMS-së për të zbatuar mbikëqyrje në tregun e sigurimeve i cili i nënshtrohet rregullimit të këtij Ligji, veçanërisht në pjesën e zbatimit të masave dhe veprimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji për stabilitet financiar i përcakton qëllimet, statusin, detyrat dhe mënyrën e punës së Komitetit për stabilitet financiar, si dhe instrumentet dhe mënyra e zbatimit të politikës nacionale makroprudente.

Ligji për masat restriktive u cakton obligime shtesë subjekteve përgjegjëse për ndërmarrjen e masave për parandalimin e pastrimit të parave në drejtim të identifikimit dhe ndërmarrjes së veprimeve (masave financiare) kundër personave për të cilët janë vendosur masa kufizuese nga BE-ja ose Kombet e Bashkuara. “Masat financiare” sipas nenit 5 të Ligjit për masat kufizuese përkufizohen si ndalim i përdorimit, mbartjes, konvertimit, transferimit ose lloji tjetër i posedimit të pronës, ndalim i vënies në disponim të çdo lloji pasurie, drejtpërdrejt ose tërthorazi, si dhe ndalim i krijimit ose vazhdimin të marrëdhënies afariste.

3. MJEDISI VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, në vitin 2022 prodhimi i brendshëm bruto real (në tekstin e mëtejshëm “PBB”) vlerësohet se shënoi rritje prej 2,1%. Domethënë pas rënies së thellë prej 6,1% në vitin 2020 si rezultat i krizës ekonomike dhe shëndetësore të shkaktuar nga pandemia e kovid 19, gjatë vitit 2021 u vu re rimëkëmbje shkallë-shkallë e ekonomisë vendase që rezultoi me normë të rishqyrtuar të rritjes të PBB-së me 3,9%.

Ngadalësimi i rritjes në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka ndodhur kryesisht për shkak të efekteve të pavolitshme të invazionit ushtarak të Rusisë mbi Ukrainën, e cila ka nxitur sfida të reja globale lidhur me krizën energjetike dhe normat e larta të inflacionit. Pas një periudhe më të gjatë të inflacionit të ulët, në vitin 2022 inflacioni shënoi përsheptim, gjatë të cilit norma mesatare e inflacionit arriti 14,2%.²

Sistemi financiar i Republikës së Maqedonisë së Veriut karakterizohet me strukturë relativisht të thjeshtë. Sistemi bankar, fondet e detyrueshme pensionale private dhe shoqëritë e sigurimeve, kanë pjesëmarrje më të lartë në aktivin e sistemit financiar dhe pothuajse kontribuojnë vazhdimisht më së shumti për rritjen e tij absolute. Pjesëmarrja e sektorit të sigurimeve (shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e përfaqësimit në sigurime dhe shoqëritë e brokerimit të sigurimeve) në strukturën e përgjithshme financiare në vitin 2021 është 3,82%.³ Segmentet e tjera të sistemit financiar, veçmas dhe bashkërisht, përfshijnë një pjesë shumë të vogël të aktivitetit të përgjithshëm të sektorit financiar, megjithëse një pjesë e tyre pothuajse shënojnë vazhdimisht rritje relativisht dinamike. Edhe përkrah rritjes së vazhdueshme të sistemit financiar, analiza krahasuese e niveleve të ndërmjetësimit financiar me vendet e tjera të Evropës Qendrore dhe Juglindore tregon rritje modeste të sektorit financiar vendor. Segmentet më të mëdha dhe më të rëndësishme të sistemit financiar janë kryesisht në pronësi të aksionarëve të huaj. Struktura e pronësisë dhe përqendrimi në segmente të veçanta të sistemit financiar nuk shënojnë ndryshime më të konsiderueshme në vitin 2021.

Lidhshmëria ndërsektorale e segmenteve të veçanta institucionale të sistemit financiar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mundësia për kalimin e rreziqeve nga njëri segment në tjetrin janë në nivel të ulët. Shkaqet për këtë janë struktura e thjeshtë e sistemit financiar, lidhshmëria e vogël e ndërsjellë e aktiviteteve të segmenteve të veçanta dhe mungesa e instrumenteve dhe shërbimeve më të ndërlikuara financiare. Stabiliteti i sistemit financiar kushtëzohet nga stabiliteti i sektorit bankar si segmenti i tij kryesor, ku janë përqendruar kursimet e sektorit jofinanciar dhe të institucioneve të tjera financiare. Lidhshmëria e pronësisë ndërmjet institucioneve të veçanta të sistemit financiar është në korniza mesatare dhe nuk paraqet burim varësie ndërmjet segmenteve të veçanta.⁴

Në kushtet e zhvillimit ende të dobët të tregjeve financiare dhe alternativave të kufizuara për investimin dhe rritjen e mjeteve të subjekteve ekonomike, një pjesë e konsiderueshme e mjeteve të institucioneve financiare jobankare janë plasuar në depozita bankare. Gjithashtu, kreditë e bankave të aprovuara për institucionet financiare jobankare paraqesin edhe një tjetër kanal të mundshëm të varësisë në sistemin financiar. Kërkesat dhe detyrimet ndërbankare janë edhe një tjetër kanal i mundshëm për varësi në sistemin financiar, megjithëse është me rëndësi relativisht të vogël.

Sigurimin bankar, përkatësisht bashkëpunimi ndërmjet bankave dhe shoqërive të sigurimit në bazë të marrëveshjes së përfaqësimit në sigurimin, në vitin 2022 e zbatojnë tetë banka (njëjtë si vitin paraprak) dhe është edhe një shembull i lidhjes ndërsektorale.

Ekziston një lidhje inherente midis sektorit të lizingut dhe sektorit të sigurimeve për shkak të detyrimit rregullator që të sigurohet mjete i lizingut te ndonjë shoqëri e sigurimit (vetëm nëse nuk

² Raporti vjetor për 2022 i Bankës Popullore të RMV-së.

³ Raporti i stabilitetit financiar për vitin 2021, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁴ Raporti i stabilitetit financiar për vitin 2021, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

është caktuar ndryshe në marrëveshjen e lizingut). Gjithashtu, oferta e a.q. produktet unit-linked të cilat paraqesin kombinim të sigurimit të jetës me investim në grup, përkatësisht sigurimit të jetës ku rrezikun e investimit e merr përsipër i siguruari, sugjerojnë për lidhshmërinë e këtij lloji të sigurimit me lëvizjet e tregjeve financiare, përkatësisht realizimet e fondeve investuese. Lidhja e pronësisë që ekziston ndërmjet institucioneve të veçanta financiare përbën edhe një kanal tjetër potencial të ndërvarësisë dhe kalimit eventual të rreziqeve nga njëri segment i sistemit financiar në tjetrin.

Gjatë analizës dhe krahasimit të indikatorëve për shkallën e **zhvillimit të tregut vendas të sigurimeve me tregjet e rajonit** dhe më gjerë, mund të nxirret përfundimi se është në nivele përafërsisht të ngjashme me vendet e rajonit më të afërt, por mjaft nën nivelin e zhvillimit të mesatares së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Kjo, para së gjithash, është rezultat i faktit se shoqëritë e sigurimeve të ne nuk janë përfshirë në fazën e akumulimit të fondeve nga kontributet e paguara nga sigurimi pensional me financim kapital, por ende janë në fazë të hershme të zhvillimit dhe të ofertës së pakove të shërbimeve në fushën e sigurimit shëndetësor vullnetar. Kjo lidhet edhe me rezultatet e matjes së parë nacionale të nivelit të edukimit financiar të popullata madhore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të kryer në vitin 2018⁵.

Ajo dëshmoi nivel agregues të shkrim-leximit financiar prej 11,8 në përputhje me metodologjinë standarde të INFE-së. Ky është nivel relativ më i ulët në krahasim me mesataren e vendeve më të zhvilluara në botën e Grupacionit 20 prej 12,7 pikësh, por nga ana tjetër është e krahasueshme me vendet e rajonit. Kjo ndikon padyshim që të kemi vëllim të pakrahasueshëm më të vogël të primeve vjetore në këto produkte në krahasim me të njëjtat në tregjet e zhvilluara të sigurimit.

Tabela nr. 1: Indikatorët më të rëndësishëm për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në vitin 2021

	PBB, çmimet aktuale (miliarda euro)	PBB për banor, çmime aktuale (euro)	Primi i shkruar bruto (milionë euro)	Norma e penetrimit (% në PBB)	Norma e dendësisë (Euro/banor)
Shqipëria	15,65	5,499	160	1.02%	56
Bosnja dhe Hercegovina	18,95	5,445	418	2.21%	120
Bullgaria	67,87	9,872	1,660	2.45%	241
Kroacia	57,40	14,229	1,559	2.72%	386
Çekia	246,47	23,030	7,225	2.93%	675
Estonia	30,66	23,052	486	1.59%	366
Hungaria	149,18	15,330	3,603	2.42%	370
Kosova	7,64	4,251	119	1.56%	66
Letonia	32,92	17,390	849	2.58%	449
Lituania	53,33	19,833	1,040	1.88%	373
Maqedonia e Veriut	11,74	5,673	189	1.61%	91
MALI I ZI	4,91	7,900	99	2.01%	159
Polonia	565,97	14,957	15,050	2.66%	398
Rumania	238,35	12,332	2,878	1.21%	149
Serbia	53,31	7,759	1,026	1.92%	149
Slllovakia	97,12	18	1,848	1.90%	338
Slllovenia	52,02	24,666	2,609	5.02%	1,237

⁵ Matja e parë ishte organizuar nga Banka Popullore, me mbështetje nga EFSE-ja, sipas metodologjisë standarde të INFE OECD.

Evropa Qendrore dhe Lindore - Gjithsej/Mesatare	1,705,48	14,235	40,819	2.39%	341
--	-----------------	---------------	---------------	--------------	------------

Burimi: XPRIMM, Raporti vjetor për vitin 2021

Nga 17 shtete në Evropën Qendrore dhe Lindore sipas indikatorit shkalla e penetrimit, Maqedonia e Veriut gjendet në vendin e 13-të sipas zhvillimit të tregut të sigurimit (para Shqipërisë, Kosovës, Rumanisë dhe Estonisë), ndërsa sipas indikatorit shkalla e dendësisë në vendin e 15-të (para Shqipërisë dhe Kosovës).

4. TREGU I SIGURIMEVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

4.1. SHOQËRITË E SIGURIMEVE

Gjatë vitit 2022, në tregun e sigurimeve kanë funksionuar 16 shoqëri të sigurimeve, nga të cilat 5 shoqëri sigurimesh punojnë me sigurime të jetës, ndërsa 11 të tjerat kryejnë punë të sigurimit jo-jetë.

Vetëm një shoqëri, përveç aktiviteteve të sigurimit jo-jetë, ka licencë të ushtrijë dhe të punojë në risigurime.

Shoqëritë e sigurimeve në fund të vitit 2022 kanë 1.926 punonjës, gjë që është 6,8% më shumë në krahasim me fillimin e vitit (2021: 1.803).

4.1.1. Struktura e pronësisë

Shoqëritë e sigurimeve janë në pronësi dominuese të personave të huaj juridikë në sektorin financiar (73,53%), të cilët janë pjesërisht ose tërësisht të pranishëm në 14 nga gjithsej 16 shoqëritë e sigurimeve në treg (Tabela nr. 2). Në këtë mënyrë, 12 shoqëri të sigurimeve janë pjesë e grupeve të sigurimeve me seli në vendet anëtare të BE-së, ndërsa dy shoqëri të sigurimeve janë plotësisht në pronësi të investuesve vendas.

Tabela nr. 2: Struktura e pronësisë e shoqërive të sigurimeve (përqindje)

	2022	2021	2020
1. Aksionerë të huaj	77.14%	75.67%	80.11%
1.1. Persona fizikë	0.50%	0.52%	0.33%
1.2. Persona juridikë jofinanciarë	3.11%	0.00%	0.00%
1.3. Institucione financiare	73.53%	75.16%	79.78%
2. Aksionerë vendas	22.83%	24.30%	19.86%
2.1. Persona fizikë	4.11%	4.26%	4.88%
2.2. Persona juridikë jofinanciarë	0.52%	0.54%	0.61%
2.3. Institucione financiare	18.20%	19.49%	14.37%
3. Shteti	0.03%	0.03%	0.03%
Gjithsej	100.00%	100.00%	100.00%


Burimi: AMS

4.1.2. Norma e zhvillimit

Indikatorët themelorë me të cilët matet norma e zhvillimit të tregut të sigurimeve janë norma e penetrimit dhe norma e dendësisë.⁶ Të dhënat për nivelin e penetrimit të sigurimeve në vitin 2022 dëshmojnë se PSHB-ja e përgjithshme në vend merr pjesë me 1.54% në prodhimin e brendshëm bruto, që është për 0,07% më shumë se vitin e kaluar (2021: 1,61% Ndërsa norma e dendësisë për vitin 2022 është 6.960 denarë për banor që shënon rritje prej 10,% në raport me vitin e kaluar (Grafiku 1).

⁶Norma e penetrimit llogaritet si raport i premisë bruto të polisës dhe prodhimit bruto vendor, kurse norma e dendësisë llogaritet si raport i premisë bruto të polisës dhe numrit të banorëve në vend.

Grafiku nr. 1: Tregues të zhvillimi të tregut të sigurimeve (miliona denarë; boshti i djathtë - përqindje)



Burimi: Ministria e Financave, Enti Shtetëror i Statistikës, AMS

Sektori i sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me përqendrim të ulët i cili është parakusht për konkurrencën funksionale të tregut. Indeksi Herfindal, i llogaritur nëpërmjet PSHB-së në vitin 2022 është 738,09 (2021: 747,46). Rezultat i ngjashëm tregohet nga matja e indeksit nëpërmjet fondeve të shoqërive të sigurimeve në 786,90 në vitin 2022 (2021: 812,88)⁷.

Analizuar sipas grupeve të sigurimeve, përqendrim më i lartë është i pranishëm në sigurimet e jetës, për shkak të numrit të vogël të shoqërive në këtë fushë. Te shoqëritë e sigurimeve të jetës indeksi Herfindal, i matur sipas PSHB-së, është 2.216,13 (2021: 2.407,60), ndërsa i matur sipas fondevetë shoqërive, është 2.848,08 (2021: 2.960,76).

Te sigurimi jojetë indikatorët tregojnë përqendrim të ulët, kështu që matja nëpërmjet indeksit Herfindal sipas PSHB-së në vitin 2022 është 988,50 (2021: 986,51), kurse i njëjti indikator i matur nëpërmjet fondeve është 976,59 (2021: 1.035,56).

Indikator i CR5⁸, i matur nëpërmjet pjesëmarrjes në PBSH, te shoqëritë për sigurim jo-jetë, në 2022 shënon ulje dhe është 55,72% (2021: 58,97%).

Në vijim janë tabelat ku jepen lëvizje e indeksit Herfindal dhe indikator i përqendrim në pesë shoqëritë e parë të sigurimeve (CR5):

⁷Indeksi Herfindal llogaritet sipas formulës

$$HI = \sum_{i=1}^n (S)_i^2$$

ku S është pjesa e secilës shoqëri të sigurimeve në totalin e aktiveve (primi i shkruar bruto) i sektorit të sigurimeve, dhe n është numri i përgjithshëm i institucioneve në segmentin përkatës. Kur indeksi lëviz në intervalin prej 1,000 njësi në 1,800 njësi, niveli i përqendrimit të sektorit të sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

⁸Indikator i CR5 është pjesëmarrja e 5 shoqërive të sigurimeve me pjesëmarrje më të madhe në strukturën e përgjithshme.

Tabela nr. 3: Indeksi Herfindal dhe indikator i CR5 i matur sipas PBSH-së

PBSH	2022		2021		2020	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	738.09	45.80%	747.46	52.57%	769.56	47.03%
Jo-Jetë	988.50	55.72%	986.51	58.97%	1003.06	56.86%
Jetë	2216.13	100.00%	2407.60	100.00%	2788.97	100.00%

Burimi: AMS


Tabela nr. 4: Indeksi Herfindal dhe indikator i CR5 i matur sipas mjeteve

Aktivi	2022		2021		2020	
	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5	Herfindal	CR5
I gjithë sektori	786.90	50.23%	812.88	46.55%	838.02	54.15%
Jo-jetë	976.59	56.10%	1035.56	56.23%	1070.59	60.69%
Jetë	2848.08	100.00%	2960.76	100.00%	3077.21	100.00%

Burimi: AMS

Në fund të vitit 2022, në fushën e përqendrimit të tregut në pjesën e sigurimeve jo-jetë, 4 shoqëri të sigurimeve e kalojnë pragun e pjesëmarrjes me mbi 10% në totalin e PSBH-së. Kështu që, në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut asnjë shoqëri nuk e kalon pragun e mbi 20% të pjesëmarrjes në treg (Grafiku nr. 2)


Grafiku nr. 2: Përqendrimi i tregut sipas primit të shkruar bruto në vitin 2022, në grupin e sigurimit jo-jetë (përqindje)



Burimi: AMS

Në grupin e sigurimit të jetës, edhe përkrah rritjes së dukshme mbimesatave të primeve të shkruara në vitin 2022 të tri nga pesë shoqëritë e sigurimit të jetës, ende pjesëmarrje dominuese kanë dy shoqëritë e sigurimit të jetës (Grafiku nr. 3)

Grafiku nr. 3: Përqendrimi i tregut sipas primit të shkruar bruto në vitin 2022, në grupin e sigurimit të jetës (përqindje)



Burimi: AMS

4.1.3. Primi i shkruar bruto

PSHB në sigurime dhe risigurime të shoqëritë e sigurimeve jo-jetë përfshin të gjitha shumat e primit që janë dakorduar (polica) në periudhën aktuale të kontabilitetit, pavarësisht nëse ato i referohen plotësisht ose pjesërisht periudhës së ardhshme, kurse në sigurimin e jetës primi i përgjithshëm i policës përfshin të gjitha primit e paguara deri në fund të periudhës së kontabilitetit.

Në vitin 2022 është realizuar PSHB-ja me vlerë të përgjithshme prej 12.785.429 mijë denarësh (Tabela nr. 5) që përbën rritje prej 9,94% në raport me PSHB-në e realizuar në vitin 2021 (2021: 11.629.700 mijë denarë).

Tabela nr. 5: Primi i shkruar bruto sipas klasave të sigurimit (mijë denarë)

Klasat e sigurimeve	Primi i Shkruar Bruto (PSHB)		Dinamika 22/21	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
	2022	2021		2022	2021
01. Sigurimi i aksidenteve	685,343	647,100	5.91%	5.36%	5.56%
02. Sigurimi shëndetësor	679,649	405,009	67.81%	5.32%	3.48%
03. Sigurimi i mjeteve motorike-kasko	994,104	890,288	11.66%	7.78%	7.66%
05. Sigurimi i mjeteve ajrore-kasko	74,735	88,367	-15.43%	0.58%	0.76%
06. Sigurimi i mjeteve të lundrimit-kasko	1,650	1,673	-1.37%	0.01%	0.01%
07. Sigurimi i transportit të mallrave-kargo	108,870	90,412	20.42%	0.85%	0.78%
08. Sigurimi i pasurisë nga zjarri	736,355	758,584	-2.93%	5.76%	6.52%
09. Sigurime të tjera të pasurisë	1,371,072	1,408,342	-2.65%	10.72%	12.11%
10. Autopërgjegjësia	5,207,931	4,836,286	7.68%	40.73%	41.59%
11. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të mjeteve ajrore	19,703	19,106	3.12%	0.15%	0.16%
12. Sigurimi i përgjegjësisë të përdorimit të objekteve/mjeteve të lundrimit	3,681	3,418	7.69%	0.03%	0.03%
13. Sigurime të tjera të përgjegjësisë	264,806	252,424	4.91%	2.07%	2.17%
14. Kredi	47,942	9,525	403.33%	0.37%	0.08%
15. Sigurime të garancive	256	269	-4.83%	0.00%	0.00%
16. Sigurimi i humbjeve financiare	83,482	69,169	20.69%	0.65%	0.59%
17. Sigurimi mbrojtjes ligjore	3	5	-40.00%	0.00%	0.00%

18. Sigurimi i asistencës turistike	229,345	147,949	55.02%	1.79%	1.27%
19. Sigurimi i jetës	1,782,701	1,618,576	10.14%	13.94%	13.92%
20. Sigurimi martesë-lindje	0	0	/	0.00%	/
21. Sigurimi i jetës kur rreziku i investimit merret përsipër nga i siguruari	493,801	383,198	28.86%	3.86%	3.29%
GJITHSEJ	12,785,429	11,629,700	9.94%	100.00%	100.00%
GJITHSEJ JO-JETË	10,508,927	9,627,926	9.15%	82.19%	82.79%
GJITHSEJ JETË	2,276,502	2,001,774	13.72%	17.81%	17.21%

Burimi: AMS

Trendi pozitiv është i pranishëm në të dy segmentet e sigurimeve, duke pasur parasysh se në pjesën e sigurimit jo-jetë është realizuar PSHB në vlerë prej 10.508.927 mijë denarësh (2021: 9.627.926 mijë denarë), ose 82.19% të PSHB-së totale të sektorit të sigurimeve dhe paraqet zmadhim prej 9,15% krahasuar me vitin 2021. Gjatë vitit 2022, nuk është realizuar prim i risigurimit (2021: 0).

Individualisht, në krahasim me vitin 2021, vetëm një shoqëri sigurimesh jo-jetë shënon ulje të theksuar të PSHB-së, kurse shoqëritë e tjera për sigurim jo-jete shënojnë zmadhim të primit (Tabela nr. 6)

Tabela nr. 6: Primi i shkruar bruto për shoqëritë për sigurim jo-jetë (mijë denarë)

Nr.	Shoqëri sigurimesh	Primi i shkruar bruto (PSHB)		Dinamika 22/21	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2022	2021		2022	2021
1	TRIGLAV	1,517,839	1,332,869	13.88%	14.44%	13,84%
2	UNIKA	1,141,732	1,023,456	11.56%	10.86%	10,63%
3	EUROLINK	1,125,323	1,124,298	0.09%	10.71%	11,68%
4	SAVA	1,072,970	941,572	13.96%	10.21%	9,78%
5	MAKEDONIJA	997,351	911,313	9.44%	9.49%	9,47%
6	VINER	982,855	848,348	15.86%	9.35%	8,81%
7	EVROINS	957,076	807,699	18.49%	9.11%	8,39%
8	KROACIJA JO-JETË	943,304	670,262	40.74%	8.98%	6,96%
9	OSIGURITELNA POLISA	718,676	658,248	9.18%	6.84%	6,84%
10	HALK	692,676	991,893	-30.17%	6.59%	10,30%
11	GRAVE JO-JETË	359,125	317,968	12.94%	3.42%	3,30%
GJITHSEJ JO-JETË		10,508,927	9,627,926	9,15%	100.00%	100.00%

Burimi: AMS

Në pjesën e sigurimit të jetës, që përbën 17,81% të PSHB-së së përgjithshme në sektorin e sigurimeve, është realizuar PSHB në shumë prej 2.276.502 mijë denarësh (2021: 2.001.774 mijë denarësh), që është rritje prej 13,72% në krahasim me vitin 2021.

Individualisht, në krahasim me vitin 2021, rritje të PSHB-ja vërehet te katër shoqëri të sigurimeve të jetës (Tabela nr. 7)

Tabela nr. 7: Primi i shkruar bruto për shoqëritë për sigurim jetë (mijë denarë)

Nr.	Shoqëri sigurimesh	Primi i shkruar bruto (PSHB)		Dinamika	Pjesëmarrja në PSHB-në e përgjithshme	
		2022	2021		2022	2021
1	KROACIJA JETË	719,735	688,282	4.57%	31.62%	34,38%
2	GRAVE	504,280	518,447	-2.73%	22.15%	25,90%
3	VINER JETË	399,652	348,206	14.77%	17.56%	17,39%
4	TRIGLAV JETË	367,434	199,423	84.25%	16.14%	9,96%
5	UNIKA JETË	285,401	247,416	15.35%	12.54%	12,36%
GJITHSEJ JETË		2,276,502	2,001,774	13,72%	100.00%	100.00%

Burimi: AMS

Një nga indikatorët më adekuatë për vëllimin e aktiviteteve të kryera të shoqërive të sigurimeve është analiza e vëllimit të aktiviteteve të kryera sipas klasave të ndryshme të sigurimit. Pasqyra e tillë tabelore mundëson analizë të shpërndarjes së primit për klasa të ndryshme të sigurimit sipas shoqërive të sigurimit, përkatësisht i jep përgjigje pyetjes se për cilat produkte të sigurimit janë specializuar shoqëritë e caktuara. Në këtë mënyrë, nëpërmjet të dhënave për PSHB-në sipas klasave të sigurimit, në mënyrë plotësuese është paraqitur struktura e tregut e të gjitha shoqërive të sigurimeve në vitin 2022 (Tabela nr. 8).

Tabela nr. 8: Primi i shkruar bruto për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 (mijë denarë)

Klasa e sigurimi	Jo-jetë											Gjithsej
	Makedonija	Triglav	Sava	Evroins	Eurolink	Viner	Grawe	Unika	Osiguritelna Polisa	Halk	Kroacija	
01. Sigurimi i aksidenteve	64,242	113,423	80,645	25,524	90,665	45,738	15,876	47,051	38,052	51,157	112,970	685,343
02. Sigurimi shëndetësor	57,857	123,696	61,035	23,418	152,935	8,243	0	43,939	9	52,948	155,569	679,649
03. Mjetet motorike kasko	63,439	167,517	172,559	63,388	90,656	78,619	11,126	79,197	99,222	91,307	77,074	994,104
04. Mjetet hekurudhore kasko	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
05. Mjetet fluturuese kasko	0	0	0	0	61,912	9,548	0	0	1,109	2,166	0	74,735
06. Mjetet lundruese kasko	10	178	873	1	70	143	0	77	166	132	0	1,650
07. Kargo	20,824	31,836	3,777	23,809	4,454	1,544	0	13,045	2,967	3,851	2,763	108,870
08. Prona nga zjarri dhe rreziqe tjera	149,495	92,177	73,581	80,004	136,526	16,503	3,435	42,810	38,412	43,460	59,952	736,355
09. Pronat tjera	292,993	228,253	138,926	261,784	53,963	125,809	1,330	178,460	16,215	46,029	27,310	1,371,072
10. AP (gji thsej)	282,806	567,124	477,176	463,889	423,374	657,600	323,938	681,068	485,189	370,475	475,292	5,207,931
11. Përgjegjësia nga mjete fluturuese	0	133	0	0	4,999	12,232	0	0	1,133	1,075	131	19,703
12. Përgjegjësia nga mjete lundruese	176	587	912	63	491	310	0	371	484	215	72	3,681
13. Përgjegjësia e përgjithshme	42,978	40,905	12,686	6,353	64,827	16,368	487	34,341	18,139	18,211	9,511	264,806
14. Kredia	2,254	34,214	7,813	136	0	0	0	0	0	0	3,525	47,942
15. Garancia	3	68	8	0	15	0	0	0	17	145	0	256
16. Humbjet financiare	10,140	59,480	5,393	110	439	0	0	7,596	0	196	128	83,482
17. Mbrojtja juridike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	3
18. Ndhima turistike	10,134	58,248	37,586	8,597	39,997	10,198	2,933	13,777	17,562	11,309	19,004	229,345
Gjithsej	997,351	1,517,839	1,072,970	957,076	1,125,323	982,855	359,125	1,141,732	718,676	692,676	943,304	10,508,927

Klasa e sigurimit	Jetë					Gjithsej
	Kroacia	Grave	Viner	Unika	Triglav	
19. Jeta	620,966	463,915	197,658	182,647	317,515	1,782,701
20. Martesa apo lindja	0	0	0	0	0	0
21. Sigurimi i jetës kur rreziku investues bie mbi të siguruarit	98,769	40,365	201,994	102,754	49,919	493,801
Gjithsej	719,735	504,280	399,652	285,401	367,434	2,276,502


Gjithsej: 12,785,429

Burimi: AMS

4.1.4. Struktura e pjesëmarrjes

Në PSHB-në e përgjithshme pjesëmarrje të rëndësishme ka sigurimi i mjeteve motorike me 48,51% (2021: 49,25%), që përbëhet nga sigurimi dominues nga përgjegjësia automobilistike (primi nga polisa për sigurim të obliguar nga PA dhe kartoni jeshil) që merr pjesë me 40,73% (2021: 41,59%) dhe nga sigurimi vullnetar i mjeteve motorike (kasko) që merr pjesë me 7,78% (2021: 7,66%). Vend të rëndësishëm në strukturën e PSHB-së ka sigurimi i pronës me 16,48% (2021: 18,63%), sigurimi i jetës me pjesëmarrje prej 17,81% (2020: 17,21%) dhe sigurimi i pasojave nga fatkeqësia (aksidenti) me pjesëmarrje prej 5,36% (2021: 5,56%). Struktura e klasave më të rëndësishme të sigurimit, si dhe krahasimi me vitin 2021, është dhënë në Grafikon nr. 4.

Grafiku nr. 4: Struktura e primit të shkruar bruto sipas klasave të sigurimit (përqindje)



Burimi: AMS

Zmadhim i PSHB-së prej 7,68% në krahasim me vitin 2020 është vërejtur në klasën e sigurimeve të autopërgjegjësive (AP) me prim të përgjithshëm në shumë prej 45.207.931 mijë denarësh (2021: 4.836.286 mijë denarë), kurse është rritur edhe numri i marrëveshjeve të lidhura me 8,10%. Te sigurimi kasko i mjeteve motorike me prim të përgjithshëm në shumë prej 994.103 mijë denarësh (2021: 890.288 mijë denarë) dhe rritje të njëkohshme prej 5,17% në numrin e marrëveshjeve të lidhura.

Te sigurimi i pronës vërehet ulje prej 2,75% në PSHB dhe ajo është 2.107.428 mijë denarë (2021: 2.166.926 mijë denarë), dhe ulje të njëkohshme të numrit prej 2,88% të numrit të marrëveshjeve të lidhura. Shkaku kryesor i uljes së vëllimit të sigurimeve të lidhura të pronës në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 është numri i zvogëluar i sigurimeve të lidhura për të mbjella, frutat dhe blegtorisë së bujqve.

Në suazat e sigurimit të pronës, te sigurimi bujqësor vërehet ulje prej 14,4% të numrit të marrëveshjeve të lidhura, si dhe ulje prej 23,3% të PSHB-së së realizuar për sigurim bujqësor që është 419.691 mijë denarë (2021: PSHB prej 546.854 mijë denarësh).


Vazhdon të rritet sigurimi shëndetësor vullnetar i ofruar nga kompanitë e sigurimeve, si për jetën ashtu edhe për jetën. Këta të fundit e ofrojnë si mbulim shtesë ndaj mbulimit bazë në klasat 19 dhe 21 të nenit 5 të Ligjit për mbikëqyrjen e sigurimeve. Në segmentin e sigurimit jojetë, në vitin 2022 janë lidhur gjithsej 25.555 marrëveshje për sigurime shëndetësore (2021: 18.235 marrëveshje) me PSHB të përgjithshme prej 679.649 mijë denarësh (2021: 405.009 mijë denarë), që në krahasim me vitin 2021 paraqet rritje prej 40,14% e numrit të marrëveshjeve të lidhura, përkatësisht rritje me 67,81% të PSHB-së totale.

Pas një rënie të caktuar dyshifrore të primeve të sigurimit nga pasojat e fatkeqësive (aksidentet) në vitin 2021, në vitin 2022 ka rritje si në numrin e marrëveshjeve të lidhura ashtu edhe në primin e shkruar bruto. Primi i përgjithshëm në vitin 2022 është 685.342 mijë denarë dhe nuk e ka kaluar shumën e siguruar në vitin 2020 (748.390 mijë denarë), por megjithatë ka shënuar rritje prej 5,91% në krahasim me vitin 2021 (647.100 mijë denarë).

Një nga arsyet e uljes së PSHB-së në këtë klasë sigurimesh në vitin 2021 është se rreziku i vdekjes për shkak të sëmundjes, i cili më parë mbulohej në marrëveshjet kolektive të sigurimit nga aksidentet, është transferuar duke filluar nga data 1.1.2021 në policat e sigurimit të jetës, kurse në bazë të sqarimit të dhënë nga AMS-ja.

Në grafikun nr. 5 tregohet tendenca e PSHB-së sipas klasave kryesore të sigurimeve.

Grafiku nr. 5: Trendi i primit të shkruar bruto sipas klasave të sigurimit (milionë denarë; boshti djathtas – përqindja)



Burimi: AMS

Te sigurimi jetë është realizuar PSHB në shumë prej 2.276.502 mijë denarësh (2021: 2.001.774 mijë denarë), që përbën zmadhim prej 13,72%, ku sigurimi jetë merr pjesë me 17,81 % në PSHB-në e përgjithshme të sektorit të sigurimit.

Te sigurimi tradicional jetë (klasa 19), është shënuar trend pozitiv në PSHB, i cili arrin në 1.782.701 mijë denarë (2021: 1.618.576 mijë denarë), që paraqet rritje prej 10,14%. Kjo rritje vjen kryesisht nga kontratat me afat të sigurimit të jetës që janë pa pjesëmarrje në fitim për të siguruarin, domethënë mbulojnë vetëm rrezikun e vdekjes. Numri i marrëveshjeve të lidhura me mbulime të tilla bazë u rrit veçanërisht në vitin 2021 kur kompanitë e sigurimit të jetës morën nga kompanitë e sigurimit jo-jetë një portofol të konsiderueshëm të policave të cilët më parë kishin mbulim për rrezikun e vdekjes nga sëmundja si shtesë e policës së sigurimit të fatkeqësive (aksident), si dhe sigurimin e kredimarrësve. Në

rastin e fundit, bëhet fjalë edhe për policat e sigurimit të jetës kur kredimarrësi mbron pasurinë e familjes së tij në rast vdekjeje gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë.

Në bazë të sigurimit të jetës lidhur me investimet në fondet investuese kur rreziku investues bartet nga i siguruari (klasa 21 e nenit 5 të LSSH-së), është siguruar gjithsej premi prej 493.801 mijë denarë, që paraqet rritje vjetore prej 28,86%. Primi i shkruar sipas këtyre marrëveshjeve në vitin 2021 ishte 383.198 mijë denarë.

Tabela e mëposhtme tregon strukturën e primit të shkruar bruto për sigurimin e jetës në vitin 2022, krahasuar me një vit më parë 2021.

Tabela nr. 9: Primi i shkruar bruto për sigurim jetë, në mijë denarë

	Klasa	Gjithsej 2021	Gjithsej 2022	Ndryshimi 22/201	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2022
Sigurimi jetë	19	1,618,576	1,782,701	10.14%	80.86%	78.31%
Sigurimi themelor i përgjithshëm i jetës		1,495,115	1,658,707	10.94%	74.69%	72.86%
Sigurim i përzierë		786,856	783,703	-0.40%	39.31%	34.43%
Vdekje (e afatizuar)		330,446	507,377	53.54%	16.51%	22.29%
Përjetim		157,325	149,195	-5.17%	7.86%	6.55%
Sigurim i përzierë me TBS		216,595	214,750	-0.85%	10.82%	9.43%
Vdekje (përjetë)		3,893	3,682	-5.42%	0.19%	0.16%
Sigurim shitesë i përgjithshëm		122,052	123,055	0.82%	6.10%	5.41%
Fatkeqësi (vdekje)		34,926	32,741	-6.25%	1.74%	1.44%
Fatkeqësi (invaliditet)		69,205	72,013	4.06%	3.46%	3.16%
Shëndetësi (tjetër)		17,921	18,300	2.12%	0.90%	0.80%
Sigurimi i përgjithshëm i anuitetit		1,409	939	-33.36%	0.07%	0.04%
Sigurimi i jetës kur rrezikun investues e ndërmerr i siguruari	21	383,198	493,801	28.86%	19.14%	21.69%
Gjithsej		2,001,774	2,276,502	13.72%	100.00%	100.00%

Burimi: AMS

Të dhënat mbi primet e shkruara bruto të zbërthyera sipas llojeve të produkteve, përkatësisht rreziqeve që mbulohen me këto produkte, janë një nga indikatorët që konfirmojnë tezën se zvogëlohet pjesëmarrja e sigurimeve tradicionale, të a.q. të përziera, të jetës që kanë komponent kursimi, për llogari të rritjes së a.q. sigurime të rrezikut të jetës që mbulojnë vetëm rrezikun e vdekjes, përkatësisht rritje të marrëveshjeve për sigurim të jetës ku mjetet e investuara nga primet riorientohen në blerjen e pjesëmarrësve të emetuara nga fondet investuese dhe ku i siguruari e bart rrezikun e investimeve të shoqërive që administrojnë këto fonde investimi.

Çmimi me të cilin shoqëria e sigurimit i blen aksionet nga fondi investues në emër dhe për llogari të të siguruarit janë çmimet e tregut, përkatësisht çmimet e bursës në periudhën kur i siguruari e paguan primin e dakorduar të shoqërisë së sigurimit. Marrëveshjet janë afatgjata, përkatësisht i siguruari shpesh paguan primin në një periudhë disavjeçare. Detyrimi i shoqërisë së sigurimit ndaj të siguruarit varet nga vlera e aksioneve në treg në datën në të cilën lind detyrimi i shoqërisë ndaj të siguruarit. Nëse blerjet e aksioneve në emër dhe për llogari të të siguruarit janë bërë në periudha kur vlerat e tregut të pjesëmarrjeve kanë qenë të ulëta, si dhe nëse detyrimi i dakorduar i shoqërisë së sigurimit ndaj të siguruarit ka ndodhur në një periudhë kohore kur vlerat e tregut të pjesëmarrjeve janë dukshëm më të


larta, i siguruari do të realizojë fitim, përkatësisht do të fitojë fonde më shumë se totali i investimeve, përkatësisht arkëtimeve të primeve. Dhe anasjelltas, nëse në momentin e arkëtimeve të primeve ndaj shoqërisë së sigurimit vlera e pjesëmarrjes ka qenë e lartë dhe në momentin e pagesës së detyrimeve të dakorduara ndaj të siguarit vlera e pjesëmarrjeve është e ulët, i siguruari duhet të dijë se do të fitojë më pak se sa që ka investuar, përkatësisht do të ketë humbje. Prandaj, për këto produkte thuhet se i siguruari bart rrezikun e ndryshimit të vlerës së tregut të mjeteve të investuara.

Vlera e përgjithshme e pjesëve në fondet investuese më 31.12.2022 është 913.258 mijë denarë, që përbën 7,9% të aktives së përgjithshme të pesë shoqërive të sigurimeve të jetës.

Fondet për këto polisa për sigurim të jetës janë investuar në pjesët e lëshuara nga fondet investuese me të cilat menaxhojnë tri shoqëri: VFP Fond Menaxhment SHA Ashkup, KB Publikum Invest SHA Shkup dhe Generali Investments SHA Shkup. Pjesa më e madhe, ose 71,5% e investimeve të përgjithshme të mjeteve të polisave UL janë pjesë të lëshuar nga fondi i hapur investues VFP Premium Invest të cilin e menaxhon VFP Fond Menaxhment.

Gjatë vitit 2022 shoqëritë e sigurimeve kanë lidhur 1.776.968 kontrata (polisa) sigurimi, që është rritje me 15,86% në raport me vitin 2021 kur janë lidhur 1.533.706 kontrata. Nga numri i përgjithshëm i marrëveshjeve të lidhura, 1.713.715 janë në suazat e sigurimit jo-jetë, që përbën zmadhim me 16,31% në krahasim me numrin e marrëveshjeve në vitin 2021 (2021: 1.473.386 marrëveshje), ndërsa 63.253 janë marrëveshje për sigurim jetë, përkatësisht zmadhim me 4.86% në raport me vitin 2021. Ndryshimi i numrit të marrëveshjeve të lidhura sipas klasave më të rëndësishme të sigurimeve është dhënë në grafikun nr. 8.

Grafiku nr. 6: Marrëveshje të lidhura te shoqëritë e sigurimeve (boshti majtas - numri; boshti djathtas – ndryshimi vjetor në përqindje)



Burimi: AMS

4.1.5. Dëme të paguara bruto

Shoqëritë e sigurimeve në vitin 2022 kanë paguar një vlerë të dëmeve bruto prej 5.113.008 mijë denarësh (Tabela nr. 12). Në krahasim me vitin 2021, dëmet e paguara bruto janë zmadhuar me 9,62% (2021: 4.664.222 mijë denarë). Pjesëmarrja në risigurim në dëmet e paguara bruto është 14,88%.

Tabela nr. 10: Dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve (mijë denarë)

Klasa	2022	2021	Ndryshimi 22/21	Pjesëmarrja 2022	Pjesëmarrja 2021
Autopërgjegjësia	2,208,723	2,102,153	5.07%	43.2%	45.1%
Sigurimi i pronës	766,367	709,851	7.96%	15.0%	15.2%
Sigurimi i jetës	662,827	565,318	17.25%	13.0%	12.1%
Mjete motorike (kasko)	545,250	507,183	7.51%	10.7%	10.9%
Sigurimi i shëndetit	425,912	211,276	101.59%	8.3%	4.5%
Sigurimi në rast fatkeqësie	347,249	434,078	-20.00%	6.8%	9.3%
Sigurimi i shëndetit në udhëtim	62,151	40,278	54.31%	1.2%	0.9%
Sigurimi i jetë (pjesë inves.)	42,429	29,712	42.80%	0.8%	0.6%
Klasa të tjera	36,630	45,542	-19.57%	0.7%	1.0%
Përgjegjësi e përgjithshme	15,470	18,831	-17.85%	0.3%	0.4%
Gjithsej	5,113,008	4,664,222	9.62%	100.0%	100.0%


Burimi: AMS

Në strukturën e dëmeve bruto të paguara, pjesëmarrjen më të madhe e kanë dëmet e bazuara në sigurimin e autopërgjegjësive me 43.2%, pastaj vijojnë dëmet nga sigurimet e pasurisë me pjesëmarrje 15%, dëmet e paguara nga sigurimet e jetës me 13%, dëmet nga sigurimet e mjeteve motorike kasko me 10.7% dhe sigurim shëndetësor vullnetar me 8.3% të dëmeve të përgjithshme të paguara.

Në fushën e sigurimit të pronës, sigurimet bujqësore zënë një vend të rëndësishëm me pjesëmarrje prej 37% dhe me gjithsej 283.131 mijë denarë të paguar.

Në grafikun nr.7 tregohet pjesëmarrja individuale e shoqërive të sigurimit në shumën totale të dëmeve të paguara për vitin 2022.

Grafiku nr. 7: Pjesëmarrja e shoqërive të sigurimeve në dëmet e paguara shtesë në vitin 2022 (mijë denarë), të ndara për jo-jetë dhe jetë.



Burimi: AMS

Nëse analizohet numri i dëmeve të paguara sipas klasave të veçanta të sigurimit, mund të vërehet se në vitin 2022 numri total i dëmeve të paguara në bazë të sigurimit shëndetësor vullnetar e ka tejkaluar numrin e përgjithshëm të dëmeve të paguara në klasën dominuese të sigurimit të

përgjegjësisë automobilistike. Edhe përkrah frekuencës së lartë të dëmeve në këtë klasë të sigurimit, shuma mesatare e dëmeve të paguara është shumë më e ulët në krahasim me të njëjtën në klasën më të përfaqësuar të sigurimit. Ky është indikator se një numër i madh i paraqitjeve nga të siguruarit në policat e sigurimit shëndetësor në kompanitë e sigurimeve kanë qenë për rimbursim të shumave të siguruar që kushtojnë më pak se 10.000 denarë për rast individual. Për krahasim, dëmi mesatar i paguar në bazë të sigurimit nga autopërgjegjësia në vitin 2022 ishte 77.228 denarë (Tabela nr. 11).

Tabela nr. 11: Numri i dëmeve të paguara

Klasa	2022	2021	Ndryshimi 22/21
Autopërgjegjësia	28,600	29,852	-4.19%
Sigurimi i shëndetit	46,119	23,057	100.02%
Sigurimi i pronës	9,085	8,976	1.21%
Sigurimi i mjeteve motorike (kasko)	7,617	7,843	-2.88%
Sigurimi në rast fatkeqësie	7,870	7,324	7.45%
Sigurimi i jetës	4,126	3,760	9.73%
Sigurimi i shëndetit në udhëtim	3,370	1,819	85.27%
Përgjegjësi e përgjithshme	384	371	3.50%
Jetë (pjesë inv.)	359	242	48.35%
Klasa të tjera	85	94	-9.57%
Gjithsej jo-jetë	103,130	79,336	29.99%
Gjithsej jetë	4,485	4,002	12.07%
Gjithsej	107,615	83,338	29.13%

Burimi: AMS

4.1.5.1. Ankesa nga të siguruarit

Në rast kur i siguruari, përkatësisht shfrytëzuesi i sigurimit konsideron se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet dispozitave të marrëveshjes së sigurimit, i njëjti mund të dorëzojë ankesë në:

- 1) Njësinë organizative përkatëse kompetente për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve kontraktuese në kuadër të shoqërisë së sigurimeve;
- 2) Shërbimin e auditimit të brendshëm në shoqërinë e sigurimeve;
- 3) Organizatën për mbrojtjen e konsumatorëve dhe
- 4) Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Në vitin 2022, te shoqëritë e sigurimeve janë dorëzuar 5.490 ankesa që është pothuajse 4% më shumë në krahasim me vitin 2021 (2021: 5.282 ankesa të dorëzuara). Nga të gjitha ankesat e dorëzuara, 25,63% (2021: 26,85%) janë zgjidhur pozitivisht, përkatësisht në dobi të të siguruarit/përdoruesit të sigurimit, kurse 59,29% (2021: 60,85%) janë me përgjigje negative.

Në tabelën nr. 12 paraqiten të dhëna mbi numrin dhe rezultatin e ankesave të paraqitura dhe të zgjidhura nga shoqëria e sigurimeve. Siç shihet nga tabela, 3 shoqëri të sigurimit jo-jetë devijojnë nga mesatarja e tregut për sa i përket numrit të dëmeve të paraqitura (mesatarja e tregut për vitin 2022 është 483 dëme të pranuar për shoqëri të sigurimeve të jojetës), ndërsa 2 shoqëri të sigurimeve të jetës. tejkalojnë mesataren e tregut e cila arrin në 35 ankesa të pranuar për shoqëritë e sigurimeve të jetës.

Tabela nr. 12: Ankesa të dorëzuara në shoqëritë e sigurimeve për vitin 2022

Emri i subjektit	Numri i ankesave	Numri i ankesave të zgjidhura pozitivisht	Numri i ankesave të zgjidhura negativisht	Numri i ankesave të zgjidhura pjesërisht	Numri i ankesave që janë në procesin e vendimmarrjes	Numri i ankesave për të cilat është vepruar brenda afatit	Numri i ankesave për të cilat nuk është vepruar brenda afatit
Viner	700	230	370	0	100	600	0
Viner Jetë	11	5	6	0	0	11	0
Grave	47	23	24	0	0	47	0
Grave Jo-Jetë	226	75	130	0	21	205	0
Evroins	164	1	137	26	0	164	0
Eurolink	381	46	235	38	62	319	0
Kroacia Jetë	73	29	44	0	0	73	0
Kroacia Jo-Jetë	447	103	304	24	16	431	0
Makedonija	251	45	206	0	0	251	0
Osiguritelna polisa	434	161	237	0	36	398	0
Sava	457	136	266	20	35	422	0
Triglav	845	8	462	375	0	845	0
Triglav Jetë	18	14	3	0	1	17	0
Unika	702	286	416	0	0	702	0
Unika jetë	25	4	21	0	0	25	0
Halk	709	241	394	0	74	635	0
Gjithsej jo-jetë	5,316	1,332	3,157	483	344	4,972	0
Gjithsej jetë	174	75	98	0	1	173	0
Gjithsej	5,490	1,407	3,255	483	345	5,145	0

Burimi: AMS

Të siguruarit, shfrytëzuesit e sigurimeve dhe palët e treta të dëmtuara kanë të drejtë të paraqesin parashtrësë në AMS në lidhje me punën e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive të përfaqësimit në sigurime, përfaqësuesve në sigurime dhe Byrosë Nacionale të Sigurimeve, por vetëm nëse i është adresuar më parë me shkrim subjektit dhe nuk janë të kënaqur me përgjigjen ose nëse subjekti nuk ka vendosur për parashtrësën dhe nuk e ka njoftuar me shkrim parashtruesin e saj brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga dita kur e ka pranuar.

Në vitin 2022 në AMS janë dorëzuar 256 ankesa, që paraqet një rritje prej 24% krahasuar me vitin 2021 kur janë dorëzuar 206 ankesa. 24.22% (2021: 20.39%) e të gjitha ankesave të dorëzuara në AMS janë zgjidhur në favor të dorëzuesit të kërkesës, kurse 55.47% (2021: 56.80%) janë zgjidhur negativisht. Nga të gjitha ankesat e paraqitura, 36,72% u referohen procedurave për marrëveshjet e sigurimit të përgjegjësive automobilistike, 15,23% për sigurimin e aksidenteve, 22,26% për sigurimin e pasurisë dhe pjesa tjetër u referohen marrëveshjeve të sigurimit nga klasa të tjera të sigurimit.

Në Tabelën nr. 13 janë prezantuar të dhënat mbi numrin dhe rezultatin e ankesave të dorëzuara në AMS për subjektet e sigurimit

Tabela nr. 13: Ankesat e dorëzuara nga të siguruarit në AMS në vitin 2022

Emri i subjektit	Numri i ankesave	Numri i ankesave të zgjidhura pozitivisht	Numri i ankesave të zgjidhura negativisht	Numri i ankesave që janë në procesin e vendimmarrjes	Numri i ankesave të tërhequra	Numri i ankesave pa bazë për të vepruar	
Halk	43	13	25	1	4	28	
Evroins	14	0	6	1	7		
Grave jo-jetë	14	6	3	2	3		
Makedonija	7	0	6	0	1		
Unika jo-jetë	27	7	20	0	0		
Osiguritelna polisa	25	12	10	3	0		
Viner jo-jetë	22	7	14	1	0		
Triglav	23	4	17	1	1		
Eurolink	15	3	10	2	0		
Sava	14	4	9	1	0		
Kroacija jo-jetë	16	5	11	0	0		
Kroacija jetë	6	1	5	0	0		
Unika jetë	3	0	3	0	0		
Triglav jetë	1	0	1	0	0		
Byroja nacionale e sigurimeve	1	0	1	0	0		
SN broker	7	0	0	0	7		
VFP broker	1	0	1	0	0		
Gjithsej	239	62	142	12	23		28

Burimi: AMS

Arsyet më të shpeshta të parashtrimit të ankesave në AMS, kurse në lidhje me punën e subjekteve të sigurimit, janë: problemet me zbatimin e Raportit Evropian, pakënaqësia me vlerën e dëmit, praktika e ndryshme gjyqësore, marrëveshjet e kontestuara jashtëgjyqësore, mungesa e kriterëve të vlerësimit të dëmit jomaterial, problemet gjatë lidhjes/rilidhjes së marrëveshjes së sigurimit, komunikimi i pamjaftueshëm për dëmin me të dëmtuarit, mosshpjegimi i kushteve në të cilat lidhet marrëveshja/kontrata e sigurimit nga përfaqësuesit, etj.

Ankesat e dorëzuara përmbajnë informacione të rëndësishme që Agjencia të ndërmarrë aktivitete të mëtejshme me qëllim të mbrojtjes më të mirë të të siguarve.

Prandaj, Agjencia u rekomandon shoqërive të sigurimeve t'i rishqyrtojnë kushtet për sigurim të personave nga pasojat e fatkeqësive (aksidenteve) dhe të sigurimit vullnetar shëndetësor në pjesën e tabelave të zbatuara për invaliditet, me qëllim që të përmirësohet cilësia e shërbimit dhe kënaqshmëria e të siguarve në rast të ndodhjes së rreziqeve të siguruara.

Agjencia inicioi formim të grupit të punës i cili punon në përpilimin e kriterëve për dëmet materiale, të cilat do të zbatohen me qëllim që të përmirësohet transparenca dhe efikasiteti gjatë trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesave për kompensim të dëmeve, që është në interes të të siguarve.

4.1.6. Fondet dhe burimet e fondeve

4.1.6.1. Struktura e fondeve

Aktivi i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve më 31.12.2022 është 30.393.398 mijë denarë dhe është 6,6% më i madh në raport me gjendjen në fund të vitit 2021 (31.12.2021: 28.512.618 mijë denarë).

Nëse analizohet struktura e fondeve sipas shoqërive të sigurimit, mund të konkludohet se kategoria kryesore e shoqërive të sigurimit të jetës janë investimet në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë dhe depozitat në banka. Nga ana tjetër, shoqëritë e sigurimit jo-jetë kanë një strukturë aktive më të larmishme, ku investimet në letrat me vlerë të borxhit të qeverisë dhe depozitat në banka përfaqësojnë gjysmën e vlerës së përgjithshme të aktivës, kurse gjysma tjetër përfaqësohet nga të mjetet e arkëtueshme, pjesë nga rezervat bruto teknike të transferuara në risigurime, pasuri të paluajtshme dhe mjete/fonde të tjera materiale dhe jomateriale, investime në aksione në fondet e hapura të investimeve, kufizime kohore aktive, investime në aksione, si dhe investime në fondin e garancisë pranë Byrosë Nacionale të Sigurimeve.

Vlera e kategorive të veçanta të mjeteve, si dhe pjesëmarrja procentuale në mjetet e përgjithshme, në ditën e fundit të vitit 2022 dhe 2021, për segmentin e sigurimeve jo-jetë dhe sigurimet jetë janë dhënë në tabelat nr. 14 dhe nr. 15.

Tabela nr. 14: Struktura e fondeve të shoqërive të sigurimit jo-jetë (mijë denarë)

Kategoria e fondeve	31.12.2021	31.12.2022	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2022	Pjesëmarrja 22/21
Letra shtetërore me vlerë (MKD)	5,033,432	5,273,631	27.8%	28.0%	4.8%
Depozita në banka dhe para	4,539,366	5,025,874	25.1%	26.7%	10.7%
Kërkesa	2,893,352	2,947,578	16.0%	15.6%	1.9%
Pjesë e provigjoneve teknike-bruto në risigurim	2,044,254	1,801,769	11.3%	9.6%	-11.9%
KKA – Kufizime kohore aktive	861,760	1,171,506	4.8%	6.2%	35.9%
Patundshmëri, fonde jomateriale dhe materiale	1,266,565	1,158,184	7.0%	6.1%	-8.6%
Pjesë në fondet e hapur investuese	814,619	884,525	4.5%	4.7%	8.6%
Aksione	362,991	284,750	2.0%	1.5%	-21.6%
Investime në Byronë Nacionale të Sigurimeve	185,541	185,140	1.0%	1.0%	-0.2%
Fonde të tjera	61,996	79,951	0.3%	0.4%	29.0%
Obligacione-korporative	12,448	24,657	0.1%	0.1%	98.1%
Aktiva e përgjithshme, jo-jetë	18,076,326	18,837,566	100.0%	100.0%	4.2%

Burimi: AMS


Tabela nr. 15: Struktura e fondeve të shoqërive të sigurimeve jetë (mijë denarë)


Kategoria e fondeve	31.12.2021	31.12.2022	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2022	Ndryshimi 22/21
Letra shtetërore me vlerë (MKD)	6,957,234	7,701,297	66.7%	66.6%	10.7%
Depozita në banka dhe para	1,794,134	2,016,526	17.2%	17.5%	12.4%
Investime në fonde nga provigjone të veçanta sipas marrëveshjeve unit-linked ,për sigurim të jetës	705,923	913,258	6.8%	7.9%	29.4%
Kërkesa, debi dhe paradhënie	402,319	424,408	3.9%	3.7%	5.5%
Investime në fondet e hapura investuese	268,755	177,388	2.6%	1.5%	-34.0%
Pjesë e provigjoneve teknike - bruto në risigurime	134,994	146,504	1.3%	1.3%	8.5%
Patundshmëri, fonde jomateriale dhe materiale	126,548	123,230	1.2%	1.1%	-2.6%
Fonde të tjera	9,773	45,290	0.1%	0.4%	363.4%
Obligacione-korporative	0	6,211	0.0%	0.1%	-
Aksione	37,545	1,720	0.4%	0.0%	-95.4%
Aktiva e përgjithshme jetë	10,437,225	11,555,832	100.0%	100.0%	10.7%

Burimi: AMS

Struktura e pjesëmarrjes e shoqërive të sigurimeve në fondet e përgjithshme të sektorit të sigurimeve është dhënë në grafikun nr.8

Grafiku nr. 8: Struktura e aktives së shoqërive të sigurimeve më 31.12.2022, të ndara jo-jetë dhe jetë





Burimi: AMS

4.1.6.2. Struktura e burimeve të fondeve

Pjesa më e madhe, ose 60,81% e burimeve të përgjithshme të fondeve të shoqërive të sigurimit janë provigjone teknike bruto (2021: 60,47%). Në raport me situatën në fund të vitit të kaluar, ato kanë një rritje vjetore prej 7,2%.

Dy tabelat e mëposhtme tregojnë, veçmas për jojetën dhe jetën, strukturën e burimeve të fondeve në më 31.12.2022 dhe 31.12.2021.

Tabela nr. 16: Struktura e burimeve të fondeve të shoqërive të sigurimeve jo-jetë (në mijëra denarë)

Burime të fondeve	31.12.2021	31.12.2022	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2022	Ndryshimi 22/21
Provigjone teknike-bruto	9,808,759	10,424,013	54.3%	55.3%	6.3%
Kapitali themelor	5,823,266	5,777,307	32.2%	30.7%	-0.8%
Obligime ndaj të risiguarve	801,313	880,130	4.4%	4.7%	9.8%
Obligime nga sigurimet	723,253	781,820	4.0%	4.2%	8.1%
KKP – Kufizime kohore pasive	359,790	437,557	2.0%	2.3%	21.6%
Kapital shtesë (rezervë e rivalorizuar dhe borxh i subordinuar)	421,907	297,102	2.3%	1.6%	-29.6%
Obligime të tjera	130,364	140,168	0.7%	0.7%	7.5%
Obligime në bazë të investimeve financiare	7,674	99,467	0.0%	0.5%	1196.2%
Gjithsej jo-jetë	18,076,326	18,837,566	100.0%	100.0%	4.2%

Burimi: AMS

Tabela nr. 17: Struktura e burimeve të fondeve të shoqërive për sigurim jetë (në mijë denarë)


Burime të fondeve	31.12.2021	31.12.2022	Pjesëmarrja 2021	Pjesëmarrja 2022	Ndryshimi 22/21
Provigjone teknike - bruto	7,433,841	8,059,091	71.2%	69.7%	8.4%
Kapitali themelor	1,908,181	2,184,698	18.3%	18.9%	14.5%
Provigjon i veçantë për marrëveshjet unit-linked	709,997	919,081	6.8%	8.0%	29.4%
Obligime nga sigurimet	197,913	214,090	1.9%	1.9%	8.2%
Obligime që dalin nga depozitat e	91,220	114,604	0.9%	1.0%	25.6%

shoqërive për risigurim te cedentët, në bazë të marrëveshjeve për risigurim					
Obligime ndaj të risiguruarve	41,614	28,730	0.4%	0.2%	-31.0%
KKP – Kufizime kohore pasive	13,109	22,169	0.1%	0.2%	69.1%
Obligime të tjera	13,567	10,042	0.1%	0.1%	-26.0%
Kapital shtesë (rezervë e rivalorizuar dhe borxh i subordinuar)	26,849	3,326	0.3%	0.0%	-87.6%
Gjithsej jetë	10,436,292	11,555,832	100.0%	100.0%	10.7%

Burimi: AMS


Në dy grafikët në vijim është dhënë struktura e burimeve të fondeve, për shoqëritë e sigurimit më 31.12.2022.

Grafiku nr. 9: Struktura e burimeve të fondeve, shoqëri sigurimesh – jojetë, në milionë denarë më 31.12.2022



Burimi: AMS

Grafiku nr. 10: Struktura e burimeve të fondeve, shoqëri sigurimesh – jetë, në milionë denarë më 31.12.2022



Burimi: AMS

4.1.7. Provigjonet teknike

Shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike (bruto) e shoqërive të sigurimit që ushtrojnë aktivitete të sigurimit jo-jetë në fund të vitit 2022 është 10.424.013 mijë denarë, dhe ato janë rritur për 6,3% në krahasim me gjendjen në fund të vitit paraprak.

Shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike (bruto) e shoqërive të sigurimit që ushtrojnë aktivitete të sigurimit në grupin e sigurimit të jetës është 8.059.091 mijë denarë, që paraqet rritje vjetore prej 8,4%.

Në segmentin e sigurimeve të jojetës pjesëmarrjen më të madhe e zënë provigjonet për dëmet dhe provigjonet për primet e transferuara, kurse në sigurimet e jetës vendin më të rëndësishëm e zë provigjoni matematikor.

Më shumë të dhëna për strukturën e provigjoneve bruto-teknike sipas kategorive individuale të sigurimit janë paraqitur në faqen e internetit të AMS, në tabelat përkatëse nga formularët e përmbledhur për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.


4.1.8. Fonde të cilat i mbulojnë provigjonet teknike

Fondet që mbulojnë provigjonet teknike janë ato mjete të shoqërisë së sigurimit që shërbejnë për të mbuluar detyrimet e ardhshme që rrjedhin nga marrëveshjet e sigurimit, si dhe për të mbuluar humbjet e mundshme në lidhje me ato rreziqe që lidhen me ushtrimin e aktivitetit të sigurimeve, për të cilat shoqëria e sigurimeve është e detyruar të lërë mënjanë fonde për të mbuluar provigjonet neto-teknike. Shoqëria e sigurimeve është e detyruar të investojë mjete në një shumë të paktën të barabartë me vlerën e provigjoneve teknike, pa risigurim, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve dhe në përputhje me Rregulloren për llojet dhe karakteristikat e fondeve që mbulojnë provigjonet teknike dhe fondet që mbulojnë provigjone matematikor, si dhe vendosjen dhe kufizimin e detajuar të atyre investimeve dhe vlerësimin e tyre (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 64/11, 127/14, 61/16, 36/19, 107/20 dhe 118/ 22).

Investimet e fondeve që i mbulojnë provigjonet teknike në kompanitë e sigurimit jo-jetë, në fund të vitit 2022 është 9.996.370 mijë denarë dhe mbulojnë 116% të provigjoneve të përgjithshme neto-

teknike (Grafiku nr. 11). Është ruajtur trendi i rritjes së provigjoneve neto-teknike, por edhe i investimeve në kategori instrumentesh të cilat, sipas ligjit, janë mbulim i pranueshëm i provigjoneve teknike.


Grafiku nr. 11: Mbulimi i provigjoneve neto-teknike te shoqëritë e sigurimeve jo-jetë (miliona denarë; boshti djathtas – përqindje)



Burimi: AMS

Te shoqëritë e sigurimit të jetës, investimet e fondeve nga provigjonet teknike dhe nga provigjonet matematikore është 8.332.240 mijë denarë dhe kanë mbulim të rezervave neto-teknike prej 105,3% (Grafiku nr. 12). Edhe në këtë segment është ruajtur tendenca pozitive e rritjes së rezervave neto-teknike (kryesisht e përbërë nga rezerva matematikore sipas marrëveshjeve të sigurimit të jetës), si dhe e investimeve në kategori të pranueshme të instrumenteve financiare të fondeve që i mbulojnë provigjonet teknike.

Grafiku nr. 12: Mbulimi i provigjoneve neto-teknike te shoqëritë për sigurim jete (miliona denarë; boshti djathtas – përqindje)




Burimi: AMS

4.1.9. Adekuatshmëria e kapitalit të shoqërive të sigurimeve

Në përputhje me nenet 75 dhe 76 të Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve duhet ta ruajnë vlerën e kapitalit minimum në madhësinë e nivelit të nevojshëm të marginës së aftësisë paguese. Sipas të dhënave të dorëzuara në AMS, në fund të vitit 2022, kapitali i llogaritur i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve⁹ është 7.241.199 mijë denarë. Në llogaritjen e kapitalit më 31.12.2022 nuk janë përfshirë fitimet e realizuara në vitin 2022. Analizuar sipas grupeve të sigurimit, kapitali i shoqërive të sigurimeve jo-jetë është 5.246.946 mijë denarë, kurse i shoqërive të sigurimeve jetë 1.994.254 mijë denarë. Mbi 98% e kapitalit të shoqërive të sigurimeve është kapital themelor, përkatësisht rrjedh nga kategoritë më cilësore të burimeve të mjeteve, përkatësisht të kapitalit të paguar aksionar nga aksionet e zakonshme të lëshuara, rezerva ligjore (statuare), si dhe fitime të akumuluar të pashpërndara. Është shumë e vogël pjesëmarrja e kapitalit shtesë në kapitalin e përgjithshëm të sektorit të sigurimeve. Kjo krijon besim se gjendja financiare dhe aftësia paguese e sektorit të sigurimit është pozitive.

Niveli i nevojshëm i marginës së aftësisë paguese, si indikator kryesor për kapitalin minimal të nevojshëm me të cilin duhet ta posedojë sektori i sigurimeve, i agreguar është 2.045.720 mijë denarë (te sigurimet jo-jetë 1.505.915 mijë denarë, kurse te sigurimi jetë 539.806 mijë denarë), kështu që kapitali i sektorit të sigurimeve është 3,54 herë mbi nivelin e nevojshëm të marginës së aftësisë paguese. Lëvizja e kapitalit dhe margjina e nevojshme e aftësisë paguese të shoqëritë e sigurimeve janë dhënë në grafikun nr. 13.

Grafiku nr. 13: Lëvizja e kapitalit dhe margjina e nevojshme e aftësisë paguese të shoqëritë e sigurimeve (miliona denarë)




Burimi: AMS

Madje 98.6% e kapitalit të përgjithshëm të shoqërive të sigurimeve jo-jetë, domethënë 97.2% e kapitalit të përgjithshëm të shoqërive të sigurimeve të jetës është kapitali bazë, që është indikator i cilësisë së lartë të zërave të përfshirë në llogaritjen e kapitalit të përgjithshëm, përkatësisht që gjendja financiare e shoqërive të sigurimit t'u përgjigjet rreziqeve të aftësisë paguese në rrethana të paparashikueshme të tregut. (Grafiku nr. 14)

⁹ Rregullorja e llojeve dhe përshkrimi i zërave që do të merren parasysh gjatë llogaritjeve të kapitalit të shoqërisë së sigurimeve dhe/ose risigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/11, 64/11, 61/16, 170/19 dhe 9620")

Grafiku nr. 14: Struktura e kapitalit të shoqërive të sigurimeve (veçmas për jo-jetë dhe jetë), në milionë denarë dhe në përqindje nga kapitali i përgjithshëm



Burimi: AMS

4.1.10. Rezultati financiar i punës

Në krahasim me vitin e kaluar afarist, në vitin 2022 sektori i sigurimit shënon rezultate financiare mjaft më të mira, në të dy segmentet e tregut. Fitimi i përgjithshëm i agreguar pas tatimit, në nivel sektori, në vitin 2022 arrin në 531.128 mijë denarë. Sa për krahasim, për vitin 2021 ky fitim ishte 135.630 mijë denarë (Grafiku nr. 17).

Rezultati i përgjithshëm i shoqërive të sigurimeve jo-jetë është pozitiv dhe është 307.222 mijë denarë, për dallim nga viti paraprak, 2021, kur ishte negativ dhe ishte 50.763 mijë denarë.

Rezultati i agreguar i shoqërive të sigurimit të jetës për vitin 2022 është pozitiv, ai është 223.906 mijë denarë (2021: fitim prej 186.393 mijë denarë).

Rritja e vëllimit të operacioneve të shoqërive të sigurimit jo-jetë, e shprehur nëpërmjet rritjes së primeve të shkruara bruto me një rritje relativisht shumë më të vogël të anës së shpenzimeve të llogaritjes teknike nga bilanci i fitimit, është arsyeja kryesore e përmirësimit të ndjeshëm të rentabilitetit në sektorin e sigurimeve jo-jetë në vitin 2022 krahasuar me atë të mëparshëm, në vitin 2021.

Të hyrat e përgjithshme nga primet neto nga risigurimet, në vitin 2022 në segmentin e sigurimit të jo-jetës janë 7.641.793 mijë denarë (2021: 6.750.284 mijë denarë).

Shuma e përgjithshme e dëmeve të bëra, pa risigurim, në vitin 2022 është 4.069.465 mijë denarë (2021: 3.599.811 mijë denarë); kurse, nga ana tjetër, shuma e përgjithshme e shpenzimeve operative, e reduktuar me komisione nga risiguruesve, 3.560.,785 mijë denarë (2021: 3.520.416 mijë denarë).

Të ardhurat nga investimet e llogaritur si diferencë ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve nga investimet nga pasqyra e përmbledhur e të ardhurave për vitin 2022 të shoqërive të sigurimeve jo-jetë është 338.988 mijë denarë (2021: 326.535 mijë denarë).

Në segmentin e sigurimit të jetës, ka, gjithashtu, përmirësim të përfitueshmërisë, analizuar në nivel të bilancit të agreguar të suksesit.


Ngjashëm me arsyet në segmentin e sigurimeve jo-jetë, edhe në sigurimet e jetës arsyeja kryesore e përmirësimit të përfitueshmërisë në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 është rritja e primeve, në një nivel relativisht të njëjtë të shpenzimeve të realizuara operative dhe rritja e reduktuar e provigjionit matematikor në vitin 2022 krahasuar me rritjen në vitin 2021.

Të hyrat e përgjithshme nga primet neto nga risigurimet, në vitin 2022 në segmentin e sigurimit të jetës janë 2.204.867 mijë denarë (2021: 1.927.448 mijë denarë).

Shuma e përgjithshme e dëmeve të bëra, pa risigurim, në vitin 2022 është 1.491.998 mijë denarë (2021: 1.531.287 mijë denarë); ndërsa, në anën tjetër, shuma totale e shpenzimeve operative, e reduktuar me komisione nga risiguruesit, 696.762 mijë denarë (2021: 567.100 mijë denarë).

Të ardhurat nga investimet i llogaritur si diferencë ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve nga investimet nga bilanci i agreguar i suksesit për vitin 2022 të shoqërive të sigurimit të jetës është 235.685 mijë denarë (2021: 394.163 mijë denarë).

Grafiku nr. 15: Rezultati financiar nga puna e shoqërive të sigurimeve (milionë denarë)



Burimi: AMS

4.1.10.1. Rreziqe në sektorin e sigurimeve

Viti i kaluar u karakterizua me një rritje të përgjithshme të ndjeshme të çmimeve të shumicës së produkteve. Kryesisht për shkak të konfliktit në Ukrainë dhe ndërprerjes së marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare dhe sanksioneve kundër Rusisë, për një periudhë kohore pati një mungesë globale të energjisë dhe ushqimit. Kjo shkaktoi rritje globale të çmimeve, të cilat në një kohë të shkurtër u transferuan në ekonominë vendase, e cila është e varur nga importi i këtyre produkteve.

Shoqëritë e sigurimit e dalluan rrezikun e rritjes së shpenzimeve të shkaktuar nga rritja e inflacionit dhe kanë rregulluar normat e tyre të sigurimit në përputhje me rrethanat dhe në kohën e duhur.

Kështu, rritja e çmimeve dhe shpenzimeve u amortizua nga rritja e vëllimit të shitjeve dhe të ardhurave të realizuara.

Por rreziqet kryesore për përfitimin dhe aftësinë paguese të shoqërive të sigurimit janë inhereente në natyrën e tyre, si dhe në periudhën e kaluar shumëvjeçare.

D.m.th., ato lidhen me pjesëmarrjen e lartë të shpenzimeve dhe presionin për uljen e primeve, të shprehura veçanërisht në segmentin e sigurimit të jo-jetës, i cili përfaqëson mbi 82% të primit të

përgjithshëm të sigurimit. Produktet kryesore në segmentin e sigurimeve të jo-jetës janë sigurimet e mjeteve motorike (auto-përgjegjësi dhe kasko). Ka shumë konkurrencë dhe shpenzimet e realizuara operative në këto klasa sigurimesh janë mjaft më të larta se ato të përcaktuara nga tarifat e shoqërive. Kjo ndikon negativisht mbi fondet e disponueshme nga primet e mbledhura, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për të paguar në kohë dhe drejt shumave të kompensimit për dëmet dhe detyrimet e tjera bazë nga marrëveshja e sigurimit.

Edhe mandej një pjesë e konsiderueshme e rreziqeve që mund të sigurohen mbeten të pasiguruara. Kjo vlen veçanërisht për rreziqet që lidhen me fatkeqësitë e motit, të cilat ekspertët i lidhin gjithnjë e më shpesh me efektet negative të ndryshimeve klimatike globale. Shoqëritë e sigurimeve janë shumë të kujdesshme në përcaktimin e kushteve të sigurimit dhe shpesh numri i madh i kufizimeve dhe përjashtimeve në fakt ndikon që ata që janë të siguruar të mos jenë të siguruar, përkatësisht të mos jenë të siguruar mjaftueshëm, nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar dhe nga të cilat dëshirojnë të jenë të siguruar.

Spektori vendas i sigurimit tradicionalisht zbaton strategji konservatore investimi me pjesëmarrjen kryesore të investimeve në letrat shtetërore me vlerë dhe në depozitat bankare. Ekspozimi ndaj tregjeve financiare ndërkombëtare është shumë i ulët për shoqëritë e sigurimeve të jo-jetës, por edhe shoqëritë e sigurimit të jetës nuk kanë pothuajse asnjë investim në instrumente financiare të huaja. Struktura e tillë e investimit kontribuon në stabilitetin e sektorit, pasi siguron mbrojtje ndaj rreziqeve që lidhen me paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare. Përqendrimi i lartë i investimeve në obligacionet shtetërore, në kushtet kur norma bazë e interesit është në rritje, ndikon negativisht mbi vlerën e tregut të këtyre instrumenteve, dhe si rrjedhim edhe mbi vlerën e tyre kontabël në bilanci të shoqërive të sigurimeve që i vlerësojnë këto instrumente sipas vlerës së tregut.

Në segmentin e sigurimit të jetës, ka ndryshime të rëndësishme në strukturën e portofolit të sigurimit. Për dallim nga vitet e shfaqjes dhe rritjes vjetore dyshifrore të sigurimit të jetës, vite në të cilat ka pasur sigurime të ashtuquajtura të përziera që mbulonin rrezikun e vdekjes dhe mbijetimit, dhe shpesh sillnin një kthim të garantuar për të siguruarin në fund të periudhës së afatit të policës, shoqëritë e sigurimeve të jetës i ndryshuan politikat e tyre të biznesit, këto politika u bënë më pak të dëshirueshme për të siguruarit potencialë. Periudha shumëvjeçare e normave të ulëta të interesit kontribuoi mbi një ristrukturim të theksuar të ofertës së sigurimit të jetës, ku dominuan të a.q. sigurimi i rrezikut dhe unit-linked sigurime të jetës që lidhen me investimet në fondet e investimeve ku i siguruari merr përsipër rrezikun e investimeve. Këto produkte nuk kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm në aftësinë paguese të shoqërive të sigurimeve, sepse shoqëritë e sigurimeve marrin përsipër një rrezik mjaft më të ulët në krahasim me të a.q. sigurime të përziera të jetës kur rreziku i tregut përballohet pikërisht nga të siguruarit.

Por, nga ana tjetër, një pjesë e theksuar e primeve të paguara për këto sigurime përdoren për pagim të shpenzimeve aktuale nga shoqëritë e sigurimeve, ku nëse kjo nuk është komunikuar në kohë, në mënyrë përkatëse dhe të kuptueshme me të siguruarit, mund të krijojë dhe zhvillojë rrezik tregu, reputacioni për prodhimet, në aspektin e vlerës së vërtetë që merret nga paratë e paguara nga të siguruarit.

4.1.11. Indikatorë për sektorin e sigurimit

Indikatorët në veprimtarinë e sigurimit përdoren për ndjekje më të mirë të punës së shoqërive të sigurimeve.

Koeficienti i dëmeve llogaritet si raport midis dëmeve të ndodhura në këtë periudhë dhe primit, kurse **koeficienti i shpenzimeve** paraqet raportin midis shpenzimeve për realizimin e sigurimit dhe primit. Mbledhja e këtyre dy koeficienteve e jep **koeficientin e kombinuar**. Më hollësisht, sipas grupeve

të sigurimit në Tabelën nr. 18 janë dhënë koeficientet me bazë bruto dhe bazë neto, përkatësisht pas izolimit të efektit të risigurimit.

Tabela nr. 18: Koeficiente teknike

	2022			2021		
	Koeficient i dëmit	Koeficient i shpenzimeve	Koeficient i kombinuar	Koeficient i dëmit	Koeficient i shpenzimeve	Koeficient i kombinuar
Koeficiente neto						
Jo-Jetë	53.25%	46.60%	99.85%	53.33%	52.15%	105.48%
Jetë	67.67%	31.60%	99.27%	79.44%	29.42%	108.86%
Gjithsej	56.48%	43.24%	99.72%	59.13%	47.10%	106.23%
Koeficiente bruto						
Jo-Jetë	46.18%	41.76%	87.94%	51.94%	45.46%	97.40%
Jetë	67.23%	31.23%	98.46%	78.94%	28.98%	107.92%
Gjithsej	50.13%	39.79%	89.91%	56.92%	42.42%	99.34%

Burimi: AMS

Risigurimi luan rol të rëndësishëm në menaxhimin me rreziqe të marrë përsipër në sigurim. Indikatorët financiarë sugjerojnë se shoqëritë e sigurimeve që ushtrojnë aktivitete të grupit të sigurimeve jo-jetë bartin rrezik të konsiderueshëm në risigurim, për dallim nga shoqëritë që ushtrojnë aktivitete të sigurimit të jetës. Kjo është e dukshme edhe nga tabela e sipërme në të cilën janë paraqitur koeficientet teknike bruto dhe neto nga risigurimi, veçmas për jo-jetë dhe jetë.

Vetëm një ngjarje e dëmshme e padëshiruar mund të shkaktojë pasoja negative për rezultatin financiar të një shoqërie të sigurimit, nëse nuk ka risigurim. Në aksidentet në komunikacion të autobusëve të cilët fatkeqësisht, përfunduan me shumë viktima njerëzore, fabrikat e djegura në Tetovë dhe Prilep, për fat pa viktima njerëzore, por me humbje të madhe materiale, dhe rastet e tjera të siguruar prej të cilave u shkaktoan humbje të mëdha, nuk do të mjaftonin burimet ekzistuese të mjeteve me të cilat disponojnë shoqëritë e sigurimit, nëse nuk kishin siguruar mbulim adekuat të risigurimit.

Bilanci i agreguar i të ardhurave të shoqërive të sigurimit jo-jetë për vitin 2022, njëlloj si një vit më parë, tregon se pjesa e të ardhurave bazë vjetore të shoqërive, nga primet bruto, të transferuara në risigurime është rreth 22% (2021: 23%), ose në shumë absolute, shoqëritë kanë transferuar 2.195.181 mijë denarë (2021: 2.085.331 mijë denarë) nga të hyrat e realizuara bruto nga primet në vlerë prej 9.836.974 mijë denarë (2021: 8.835.615 mijë denarë), në risigurim. Analizuar sipas shoqërive të veçanta, ka dallime të mëdha në pjesëmarrjen relative të risigurimeve në të ardhurat bruto të realizuara nga primet, kështu që në raste ekstreme kjo përqindje në të ardhurat e përgjithshme vjetore nga primet është ndërmjet 4.7% dhe 53.8%. Kësaj i përgjigjet pjesëmarrja e risigurimeve në shpenzimet e shoqërive, përkatësisht ato në bazë të kompensimit të dëmeve dhe shpenzimeve operative. Kompensimi i përgjithshëm vjetor i të risiguresve në dëmet të shoqëritë e sigurimit jojetësor në vitin 2022 është 473.081 mijë denarë (2021: 989.445 mijë denarë), që përbën 10,4% (2021: 21,6%) nga kompensimi bruto i realizuar i dëmeve në atë vit, përkatësisht, nga të gjitha dëmet e tjera prej 4.542.546 mijë denarësh (2021: 4.589.256 mijë denarë). Të hyrat e përgjithshme vjetore nga provizionet e shoqërive të sigurimit jo-jetë janë 547.072 mijë denarë (2021: 496.356 mijë denarë), që përfaqëson 24,7% (2021: 22,6%) të primeve të paguara nga shoqëritë ndaj të risiguresve. Efekti financiar neto i risigurimit në

bilancin e agreguar të suksesit për vitin 2022 është negativ dhe arrin në 1.175.028 mijë denarë (2021: -599.530 mijë denarë).

Nëse pjesëmarrja e risigurimeve në provigjonet e përgjithshme bruto teknike analizohet nëpërmjet bilancit të agreguar në gjendjen e shoqërive të sigurimit jo-jetë, më 31.12.2022 shuma e përgjithshme e provigjoneve teknike të transferuara në risigurim arrin në 1.801.769 mijë denarë (31.12.2021: 224.254 mijë denarë), që paraqet 17,3% (2021: 20,8%) nga shuma bruto e provigjoneve teknike, e cila është 10.424.013 mijë denarë (31.12.2021: 9.808.759 mijë denarë).

Norma e kthimit të investimit (ROI) llogaritet si raport i të ardhurave minus shpenzimet e investimit dhe shumën e investimit. Norma e kthimit nga investimet në nivel industrie për vitin 2022 është 2.85% dhe tregon një rënie në krahasim me vitin e kaluar (2021: 3.89%). Sigurimi në vitin 2022 është 3.15% krahasuar me 3.28% të arritur në vitin 2021, ndërsa në rastin e sigurimit të jetës në vitin 2022 kjo normë është 2.52%, që paraqet një rënie në krahasim me vitin paraprak kur ka qenë 4.61%.

Norma e kthimit të fondeve (ROA) llogaritet si raport i fitimit/humbjes para tatimit të fondeve të përgjithshme. Në nivel industrie ky indikator është 2.08%, që do të thotë rritje krahasuar me një vit më parë kur ishte 0.72%. Veçmas, sipas grupeve të sigurimit, shkalla e kthimit të fondeve në sigurimet jo-jetë në vitin 2022 është 2,02% përkundrajt -0,02% në vitin 2021, kurse në sigurimet e jetës në vitin 2022 është 2,18% përkundrajt 2,01% në 2021.

Norma e kthimit të kapitalit (ROE) llogaritet si raport fitim/humbje para tatimit dhe kategorisë së kapitalit dhe rezervave të bilancit të gjendjes. Në nivel industrie, ky tregues është 7,77% kundrejt 2.56% në vitin 2021. Veçmas, sipas grupeve të sigurimeve, shkalla e kthimit të kapitalit për sigurimet jo-jetë në vitin 2022 është 6,39%, që paraqet një përmirësim të dukshëm krahasuar me një vit më parë, kur ka qenë negativ dhe ishte -0,06%. Në sigurimet e jetës në vitin 2022 është 11.5%, që është një rritje e vogël krahasuar me vitin 2021 kur ka qenë 10.83%.

Koeficienti i borxhit llogaritet si raport i detyrimeve të përgjithshme ndaj fondeve të përgjithshme. Ky koeficient tregon se sa nga fondet financohen nga detyrimet (provigjonet teknike dhe detyrimet e tjera), pa përfshirë provigjonet kapitale dhe ligjore. Në vitin 2022 ky koeficient është 73,23%, që paraqet rritje të lehtë krahasuar me vitin 2021, kur ka qenë 71,75%.

Pasqyra e të gjithë indikatorëve financiarë është dhënë në Tabelën nr. 19.

Tabela nr. 19: Indikatorë financiarë

	2022				2021			
	ROI	ROA	ROE	Borxhi	ROI	ROA	ROE	Borxhi
Jo-Jetë	3.15%	2.02%	6.39%	68.43%	3.28%	-0.02%	-0.06%	66.15%
Jetë	2.52%	2.18%	11.50%	81.06%	4.61%	2.01%	10.83%	81.46%
Gjithsej	2.85%	2.08%	7.77%	73.23%	3.89%	0.72%	2.56%	71.75%

Burimi: AMS

4.2. NDËRMJETËSIMI NË SIGURIME

Roli i ndërmjetësimit të shitjeve ka një ndikim në rritje në sektorin e sigurimeve. Gjatë vitit 2022, 38.76% (2021: 43.14%) e PSHB-së së arritur është realizuar përmes shitjeve direkte nga shoqëritë e sigurimit, ndërsa 61.24% (2021: 56.86%) është realizuar nëpërmjet kanaleve indirekte të ndërmjetësimit (tabela nr. 20).

Tabela nr. 20: Struktura e kanaleve të shitjes së policave sipas PSHB-së (mijë denarë)

	Jo-jetë				Jetë				Gjithsej			
	2022		2021		2022		2021		2022		2021	
	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	%	PSHB	Pjesëmarrja
Shitja e drejtpërdrejtë	4466513	42,50%	4584193	47,61%	489543	21,50%	433187	21,64%	4956056	38,76%	5017380	43,14%
Shoqëri të brokerimit në sigurime	3153068	30,00%	2937866	30,51%	911547	40,04%	863327	43,13%	4064615	31,79%	3801193	32,69%
Shoqëri të përfaqësimit në sigurime	808029	7,69%	685633	7,12%	218633	9,60%	214775	10,73%	1026662	8,03%	900408	7,74%
Agjenci turistike	21618	0,21%	13773	0,14%	0	0,00%	0	0,00%	21618	0,17%	13773	0,12%
Sallon automobilash	16701	0,16%	14805	0,15%	0	0,00%	0	0,00%	16701	0,13%	14805	0,13%
Banka	344238	3,28%	205923	2,14%	476564	20,93%	308664	15,42%	820802	6,42%	514587	4,42%
Përfaqësues	1673495	15,92%	1158741	12,04%	180213	7,92%	181808	9,08%	1853708	14,50%	1340549	11,53%
Kanale të tjera distributive	25265	0,24%	26999	0,28%	0	0,00%	0	0,00%	25265	0,20%	26999	0,23%
Gjithsej	10508927	100,00%	9627933	100,00%	2276500	100,00%	2001761	100,00%	12785427	100,00%	11629694	100,00%

Burimi: AMS

Në strukturën e kanaleve të shitjes të sigurimi jo-jetë, pjesëmarrje më të madhe ka shitja e drejtpërdrejtë me 42,5%, pastaj është shitja nëpërmjet shoqërive brokere të sigurimit me 30%, shitja nëpërmjet përfaqësuesve (personave fizik) me 15,92%, shitja nëpërmjet shoqërive brokere të sigurimit me 30%, shitja nëpërmjet përfaqësuesve (persona fizik) me 15,92%, shitja nëpërmjet shoqërive të përfaqësimit në sigurim me 7,69%, bankat me 3,28% dhe 0,61% nëpërmjet kanaleve të tjera distributive. Ndërsa, në strukturën e kanaleve të shitjes të sigurimi i jetës, pjesëmarrje më të madhe kanë shoqëritë brokere të sigurimit me 40,04%, pastaj janë shitja e drejtpërdrejtë me 21,5%, bankat me 20,93%, shitja nëpërmjet shoqërive për përfaqësim në sigurime me 9,6% dhe 7,92% shitja nëpërmjet përfaqësuesve (persona fizikë).

4.2.1. Përfaqësimi në sigurime

Përfaqësimi në sigurime paraqet përgatitjen dhe lidhjen e kontratave të sigurimit, në emër dhe në llogari të një ose më shumë shoqërive të sigurimit, për produktet e sigurimit që nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën. Përfaqësimi në tregun e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut bëhet nëpërmjet përfaqësuesve të sigurimeve – personave fizikë, shoqërive të përfaqësimit në sigurime dhe bankave që kanë marrë leje për të kryer përfaqësim në sigurime. Nëpërmjet këtyre kanaleve, në vitin 2022 është realizuar 28,95% e PSHB-së (2021: 23,69%), gjegjësisht 3.701.172 mijë denarë (2021: 2.755.544 mijë denarë), që paraqet rritje për 34,3% në krahasim me vitin paraprak.

Përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë bëhet në bazë të licencës nga AMS-ja, të cilën e kanë marrë pasi kanë dhënë paraprakisht provimin për ushtrimin e aktivitetit të përfaqësimit në sigurime. Në totalin e PSHB-së, përfaqësimi në sigurime nëpërmjet personave fizikë merr pjesë me 14,5%.

Gjatë vitit 2022 janë lëshuar gjithsej 363 licenca të reja për përfaqësues në sigurime dhe pëlqim për bankën në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të përfaqësimit në sigurimin, kështu që numri i bankave që veprojnë si përfaqësues sigurimesh shënoi rritje në 8.


Në totalin e BPV-së, shoqëritë përfaqësuese të sigurimit në vitin 2022 marrin pjesë me 1.026.662 mijë denarë ose 8,03% nga totali i ndërmjetësimit dhe në krahasim me vitin e kaluar është shënuar rritje prej 14% (2021: 900.408 mijë denarë).

Veprimtarinë e përfaqësimit në sigurime mund t'i ushtrojë edhe banka e cila ka marrë licencë për ushtrimin e aktivitetëve të përfaqësimit në sigurime nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të dakordimit paraprak të AMS-së. Bankat morën pjesë me 820,802 mijë denarë ose 6,42% në totalin e PSHB-së, që paraqet rritje prej 59,5% në krahasim me vitin 2021 (2021: 514,587 mijë denarë).

Gjatë vitit 2022 nëpërmjet shoqërive të përfaqësimit në sigurime janë lidhur 98.975 kontrata sigurimesh (polica) (2021: 78,424), që është 26,2% më shumë në krahasim me vitin paraprak. Nëpërmjet bankave, në vitin 2022 janë lidhur 203.587 kontrata sigurimi (2021: 184.649), që paraqet një rritje prej 10.3% në krahasim me vitin paraprak.

Shpërndarja e PBV-së, sipas klasave të sigurimit, ndërsa e realizuar nga shoqëritë e përfaqësimit dhe bankave është paraqitur në Grafikon nr. 16.

Grafiku nr. 16: Struktura e PSHB-së, sipas klasave të sigurimit



Burimi: AMS

4.2.2. Veprimtari brokerimi në sigurime


Veprimtaritë brokere të sigurimit nënkuptojnë ndërmjetësim në dakordimin e mbulesave të sigurimit dhe risigurimit, si dhe gjatë realizimit të kërkesave të dëmeve për ngjarjen e realizuar të dëmit të siguruar te shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve, në emër dhe për llogari të klientëve. Nëpërmjet këtij kanali të shpërndarjes, shoqëritë e sigurimit në vitin 2022 kanë realizuar 31,79% të PSHB-së (2021: 32,69%), përkatësisht 4.064.615 mijë denarë (2021: 3.801.193 mijë denarë) që përbën rritje prej 6,9% në raport me vitin e kaluar.

Në vitin 2022 në AMS kanë mbërritur dhe është vendosur pozitivisht për tri kërkesa për marrjen e lejes për themelimin e shoqërisë së brokerimit në sigurime.

Në këtë periudhë shoqëritë e brokerimit në sigurime kanë realizuar 459.839 polica (2021: 405.595) që përbën zmadhim prej 13,4%, në raport me vitin e kaluar.

Shpërndarja e PSHB-së së përgjithshme sipas klasave të sigurimeve, kurse e realizuar nga shoqëritë e brokerimit të sigurimeve është paraqitur në grafikon nr. 17.

Grafiku nr. 17: Struktura e PSHB-së sipas klasave të sigurimit



Burimi: AMS

4.3. BYROJA NACIONALE E SIGURIMEVE

Në përputhje me Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport, Byroja Nationale e Sigurimeve (në tekstin e mëposhtëm: "BNS") ushtron aktivitetet e parapara me marrëveshjet ndërkombëtare për sigurim të pronarëve dhe përdoruesve të mjeteve motorike nga përgjegjësia në qarkullim (kartoni i gjelbër) dhe i përfaqëson shoqëritë e sigurimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të sigurimeve. BNS-ja lëshon dhe shtyp, gjithashtu, kartonët jeshilë ndërkombëtarë për nevojat e anëtarëve, mban evidencë statistikore dhe kryen përpunim statistikor të të dhënave statistikore të shoqërive të sigurimeve, vendos dhe mban sistem qendror për evidencën e policave dhe dëmeve nga përdorimi i mjeteve motorike.

BNS-ja është anëtare e Këshillit të Byrove në Bruksel që nga viti 1994, që ka për qëllim të lehtësojë qarkullimin rrugor ndërkombëtar të mjeteve motorike dhe atyre shoqëruese, nëpërmjet sigurimit nga përgjegjësia për dëme të shkaktuara nga persona të tretë, sipas kushteve të cilat janë përcaktuar në vendin e vizituar dhe garanton se personave të dëmtuar në rast të fatkeqësisë rrugore do t'u kompensohet dëmi i shkaktuar me përdorim të mjetit motorik me zbatim të legjislacionit kombëtar të atij vendi. Njëkohësisht, si anëtare e Këshillit, BNS-ja merr pjesë në punën e Grupit Evropian Juglindor ku marrin pjesë vendet nga rajoni.

Në BNS janë anëtare njëmbëdhjetë shoqëri sigurimesh, përkatësisht të gjitha shoqëritë e sigurimeve jo-jetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në raportin e punës të cilin BNS-ja e dorëzoi në AMS, në përputhje me nenin 54 paragrafi (3) të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Transport, është dhënë punimi financiar i BNS-së dhe punimi financiar i Fondit Garantues për vitin 2022.

Me bilancin më 31.12.2022 fondet e përgjithshme të BNS-së arrijnë në 297.538 mijë denarë, nga të cilat 166.000 mijë denarë, ose 55.8% janë depozita në banka, 98.407 mijë denarë, ose 33,1% kërkesa, 21.375 mijë denarë, ose 7,2% janë para të gatshme në llogaritë bankare, kurse pjesa tjetër janë mjete jomateriale dhe materiale. Krahasuar me një vit më parë, fondet e përgjithshme shënuan një rënie prej 1.76%. Në detyrimet e përgjithshme dhe në kapitalin e BNS-ve në vitin 2022, kapitali merr pjesë me 63,72%, ndërsa detyrimet me 36,28%. Në vitin 2022, BNS-ja ka realizuar fitim në vlerë prej 1.992 mijë denarë (2021: fitim prej 2.338 mijë denarë).

4.3.1. Fondi garantues i BNS-së

BNS-ja, në përputhje me nenin 58 të Ligjit për Sigurim të Detyruar në Transport, formon Fond garantues i cili shërben për pagim të:

- dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete motorike dhe rimorkio të panjohura dhe të pasiguruara, barka dhe anije me fuqi motorike të pasiguruara si dhe mjete fluturuese të pasiguruara;
- dëmeve të shkaktuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga mjete të transportit të regjistruara për transport të udhëtarëve në qarkullimin publik për të cilat pronarët nuk kanë bërë marrëveshje sigurimi të udhëtarëve nga pasojat e fatkeqësisë - aksidentit;
- dëmeve nga sigurimet e obligueshme për të cilat personat e dëmtuar nuk mund t'i marrin pagesat për shkak të ndërprerjes së punës së shoqërisë së sigurimeve me të cilën është bërë marrëveshje për sigurim, ku paguhet vetëm ajo pjesë e dëmit i cili nuk është kompensuar nga masa e falimentimit të shoqërisë së sigurimeve; dhe

- dëmeve nga mjetet motorike të siguruara të cilat kanë prejardhje nga territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilat në përputhje me Marrëveshjen e Kretës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare i garanton Byroja Nacionale e Sigurimeve.

Puna e Fondit Garantues bazohet në Ligjin për Sigurim të Detyruar në Transport si dhe Rregulloren për formim dhe përdorim të Fondit Garantues dhe Udhëzimin për mbajtjen e evidencës dhe mënyrën e pagesës së mjeteve nga Fondi Garantues, të miratuar nga BNS-ja.

Tabela nr. 21: Pjesëmarrja e Fondit Garantues sipas shoqërive të sigurimeve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 (në denarë)

Emri i shoqërisë së sigurimeve	PSHB për të gjitha sigurimet e obliguara	% e pjesëmarrjes në PSHB për të gjitha sigurimet e obliguara	Pjesëmarrja në Fondin garantues
Makedonija	268,775,922	5.21 %	9,596,889
Triglav	550,979,406	10.68 %	20,090,591
Evroins	458,733,065	8.89 %	14,990,077
Sava	465,441,413	9.02 %	16,890,036
Viner	666,629,278	12.92 %	23,624,943
Eurolink	422,772,540	8.20 %	14,874,787
Grave Jo-Jetë	336,459,918	6.52 %	11,382,951
Unika	677,054,988	13.13 %	23,867,951
Osiguritelna Polisa	478,117,124	9.27 %	17,140,071
Halk osiguruvanje	362,739,927	7.03 %	18,386,008
Kroacija Jo-Jetë	470,708,646	9.13 %	14,036,696
Gjithsej	5,158,112,227	100.00 %	184,881,000

Burimi: Raporti i punës së BNS-së për vitin 2022

Shoqëritë e sigurimeve të cilat ushtrojnë aktivitete të obligueshme të sigurimeve nga autopërgjegjësia janë të detyruara të paguajnë mjete në Fondin Garantues në shumë proporcionale me primin e realizuar sipas klasave të veçanta të sigurimit të obligueshëm nga autopërgjegjësia në tremujorin paraprak, për tremujorin vijues gjatë vitit aktual.

Në përputhje me vendimin e Bordit Drejtues të BNS-së çdo vit kalendarik kryhet shpërndarje e re e mjeteve të Fondit Garantues në vlerë prej 3.000.000 eurosh, sipas përqindjes së pjesëmarrjes së shoqërisë së sigurimeve në primin e përgjithshëm të shkruar për të gjitha sigurimet e obligueshme. Për vitin 2022 pjesëmarrja në Fondin Garantues sipas shoqërive të sigurimeve është dhënë në Tabelën nr. 21.

4.3.2. Rimbursimi i dëmeve nga Fondi garantues

Në përputhje me nenin 60 paragrafi (4) të Ligjit për sigurime të detyruara në transport, shoqëria e sigurimeve që ka kryer përpilim dhe pagesë të kërkesës për kompensim të dëmit ka të drejtë të kthimit të mjeteve të paguara nga mjetet e Fondit garantues.

Nga mjetet e Fondit garantues nuk kompensohen dëmet e ndodhura nga përdorimi i mjeteve motorike të huaja të pasiguruara që qarkullojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse për të cilat vlejné marrëveshjet e veçanta ndërkombëtare në të cilat nënshkruese është Republika e Maqedonisë së Veriut.

Tabela nr. 22: Dëmet e paraqitura dhe të pranuar për rimbursim nga Fondi Garantues për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022

Emri i shoqërisë së sigurimeve	Numri i dëmeve të raportuara për rimbursim	Numri i dëmeve të pranuar në Fondin garantues	Emri i shoqërisë së sigurimeve
Makedonija	45	45	6,005,492
Trigllav	35	35	5,015,429
Evroins	51	51	12,352,792
Sava	69	69	13,522,981
Viner	65	65	9,811,254
Eurolink	45	45	4,315,440
Grave jojetë	51	51	25,170,216
Unika	58	58	9,150,680
Osiguritelna polisa	71	71	9,426,469
Halk	56	56	8,941,978
Kroacija jojetë	48	48	14,799,919
Gjithsej	594	594	118,512,650

Burimi: Raporti i punës së BNS-së për vitin 2022

Në vitin 2022 në BNS nga shoqëritë e sigurimeve janë paraqitur 594 dëme për rimbursim dhe të gjitha dëmet janë pranuar dhe rimbursuar në shumën e përgjithshme prej 118.513 mijë denarë.

Numri i dëmeve të paraqitura për rimbursim në Fondin garantues në vitin 2022 (594) është zvogëluar në 153 në krahasim me vitin 2021 (747), përkatësisht shënon ulje prej 20,48%.

Dëmi mesatar i paguar në vitin 2022 është 191.363 denarë dhe shënon ulje prej 1,94% në raport me dëmin mesatar të paguar në vitin 2021.

Numri i dëmeve të paraqitura dhe të pranuar për rimbursim nga Fondi garantues gjatë vitit 2022, si dhe shuma e dëmeve të pranuar janë dhënë në Tabelën nr. 22.

Numër 01-585/1

Shkup, 29.06.2023

Kryetar i Këshillit të Ekspertëve,

Kërste Shajnoski